

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6050  
E martë, 30 qershor 2020  
çmimi 0.40 €

Pas rritjes së numrit të të infektuarve me Covid-19, qeveria paralajmëron kthim të masave



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, U ËSHTË DREJTUAR TË HËNËN QYTETARËVE PËR PROPOZIMAKTAKUŽËN E GJYKATËS SPECIALE NDAJ TIJ

## GABIME POLITIKE MUND TË KEM BËRË, KRIME LUFTË ASNJËHERË



### - Jap dorëheqje nëse konfirmohet aktakuza

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka mohuar pretendimet e propozimaktakuzës së Gjykatës Speciale për krime lufte. Në paraqitjen e parë për këtë çështje, shefi i shtetit ka thënë se gabime politike në paqe mund të ketë bërë, por krime lufte asnjëherë. "Edhe po të kthehesha mbrapa, në kohën e zezë të Sllobodan Millosheviqit, do të bëja të njëjtën gjë, duke iu përgjigjur plumbit armik me plumbin e etjes për liri dhe duke mos i hyrë kurrë në hak asnjë qytetari serb, rom apo shqiptar", ka thënë ai. Presidenti Thaçi ka bërë me dije se, nëse i konfirmohet akuzat, do të japë dorëheqje. Ai e ka mbrojtur vendimin e vet për formimin e Gjykatës Speciale, duke thënë se Kosova nuk kishte rrugë tjetër

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, KA FILLUAR TË HËNËN VIZITËN NË KOSOVË

## Rama: Aktakuza e Speciales do të mbetet njollë turpi për drejtësinë

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, pasi ka mbërritur të hënën në Prishtinë, e ka kundërshtuar propozimaktakuzën e Gjykatës Speciale për Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin, duke e quajtur fletërrufe dhe

njollë turpi e shekullit XXI në historinë botërore të drejtësisë. Në takimet me liderët institucionalë dhe politikë, Rama ka dhënë mbështetjen e plotë të qeverisë shqiptare për institucionet dhe popullin e Kosovës



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

PROMOTORËT  
E LIRISË F. II

Shkruan:  
Ramadan AVDIU



**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Meta: Nevojitet strategji afatgjatë për t'u përballur me pandeminë

TIRANË, 29 QERSHOR (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se shtimi i rasteve të qytetarëve të prekur nga Covid-19, veçanërisht i numrit të viktimeve, krahasuar me periudhën e fillimit të pandemisë dhe të karantinimit, kërkojnë urgjentisht një reflektim serioz, të përgjegjshëm dhe transparent.

"Nevojitet një strategji konkrete afatgjatë, jo sporadike dhe mediatike, për përballimin dhe vënien nën kontroll të përhapjes së kësaj pandemie që po rrezikon

seriozisht shëndetin dhe jetën e qytetarëve. Gjithashtu, është i domosdoshëm një komunikim edhe më intensiv me vendet e rajonit dhe ato të BE-së, si dhe me OBSH-në, për t'i harmonizuar veprimet dhe shkëmbyer informacionin në kohë reale për orientimin e një strategjie që lejon daljen sa më të sigurt dhe të shpejtë nga pandemia", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".

Meta ka shprehur ngushëllime për familjet që kanë humbur njerëzit e tyre më të

dashur nga Covid-19 si dhe u ka uruar shërim sa më të shpejtë të gjithë të prekurve nga ky virus. "Theksoj domosdoshmërinë për respektimin me rigorozitet nga të gjithë të protokolleve shëndetësore dhe masave parandaluese. Është me rëndësi jetike rritja e efikasitetit të këtyre masave, përmes ndërgjegjësimit, transparencës, gjithëpërfshirjes dhe rritjes së frymës së bashkëpunimit, pasi objektivi madhor i përbashkët duhet të jetë vetëm mbrojtja e shëndetit të qytetarëve dhe



ekonomisë kombëtare. Në veçanti është e domosdoshme të rritet besueshmëria e menaxhimit të pandemisë,

tani kur po hyjmë në pikun e sezonit turistik, në mënyrë që të përfitojmë maksimalisht prej tij", ka deklaruar Meta.

## Diskutohet rreth provimeve dhe sfidave të vitit akademik 2019-2020


**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Marjan Dema, ka mbajtur të hënën takimin e përmuajshëm me studentët, në të cilin është diskutuar rreth afateve të provimeve dhe sfidave për përfundimin e vitit akademik 2019/20.

I shoqëruar nga prorektori për mësim dhe çështje për studentë, prof. dr. Hysen Bytyqi, si dhe këshilltari i tij ligjor, prof. ass. Flamur Hyseni, rektori Dema ka folur me studentët e pranishëm rreth kërkesave dhe shqetësimeve të tyre në këtë fazë të përfundimit të këtij viti jo të zakonshëm akademik, i cili në muajt e fundit është zhvilluar në mënyrë virtuale.

Rektori, prof. dr. Marjan Dema, ka kërkuar nga studentët që t'i marrin masat e nevojshme për t'u vetëmbrojtur dhe për t'i mbrojtur të tjerët nga pandemia Covid-19, ndërkaq i ka falënderuar ata për entuziazmin e treguar për t'u bashkuar mësimi virtual, duke e



shndërruar këtë sfidë të mësimi virtual në një sukses për UP-në. Njëherësh, ai i ka motivuar ata që të mos dorëzohen përballë sfidave që studimet dhe pandemia kanë mundur të sjellin tek ata, por t'i tejkalojnë ato si një mësim shtesë në jetën

e tyre.

Studentët nga njësi të ndryshme akademike, pjesëmarrës në këtë takim virtual, e kanë falënderuar rektorin për hapësirën e dhënë për adresim të shqetësimeve të tyre si dhe kanë theksuar që mësimi virtual

ka qenë shumë efektiv, por sfidat vazhdojnë të jenë të pranishme tash në fazën e vlerësimit të mësimnxënies së tyre.

Takimet e studentëve me rektorin janë takime të përmuajshme, gjatë të cilave

diskutohet për tema të ndryshme që prekin cilësinë e jetës studentore në UP.

Takimi "Kafe dhe diskutim me rektorin", për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, në dy sesionet e fundit është mbajtur online.

## OBSH-ja: Pandemia me koronavirus nuk është as afër fundit

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Shefi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), Tedros Adhanom Ghebreyesus, ka paralajmëruar se pandemia me koronavirus "nuk është as afër fundit" teksa numri i rasteve të prekura me këtë virus ka kaluar shifrën 10 milionë, ndërkohë që janë raportuar mbi 500 000 viktime. "Ndonëse shumë shtete

kanë shënuar përparim në nivel global, ritmi i pandemisë është duke u përshpejtuar", ka thënë Tedros përgjatë një fjalimi për media, duke shtuar se bota do të ketë nevojë "për më shumë durim dhe zemërgjerësi në muajt vijues".

Tedros, po ashtu, ka thënë se pandemia ka vënë në pah



më të mirën dhe më të keqen e njerëzimit, duke cituar aktet e solidaritetit, por edhe ato të dezinformatave dhe tentimeve për politizim të koronavirusit. Këto komente kanë ardhur një ditë pasi OBSH-ja ka raportuar për një tjetër rekord të ri të numrit të të prekurve me koronavirus në 24 orë, 189 000 persona.



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka filluar të hënën vizitën në Kosovë

# Rama: Aktakuza e Speciales do të mbetet njollë turpi për drejtësinë

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, pasi ka arritur të hënën në Prishtinë, e ka kundërshtuar propozimaktakuzën e Gjykatës Speciale për Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin, duke e quajtur atë fletërrufe e cila do të hyjë si njollë turpi e shekullit XXI në historinë botërore të drejtësisë. Në takimet me liderët institucionalë dhe politikë, Rama ka dhënë mbështetjen e plotë të qeverisë shqiptare për institucionet dhe popullin e Kosovës

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

shkruar Rama.

Në vizitën e tij, ai ka qenë i shoqëruar me ministrin në

konsideron Shqipërinë si partneren më të afërt dhe strategjike në procesin e realizimit të synimeve integruese euroatlantike.

Duke folur për gjendjen e re të krijuar në vend, kryeministri Hoti ka ritheksuar se Republika e Kosovës tashmë ka një kulturë të dëshmuar institucionale për t'i përballuar me dinjitet sfidat e tilla që, natyrisht, nuk janë të lehta. Ai ka thënë se, pavarësisht prej rrethanave dhe vështirësive që mund të dalin gjatë procesit, Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që ta zhvillojë agjendën e integritimit



përherëshme paqeje e stabiliteti, e cila do të rezultojë me njohjen e ndërsjellë në mes dy vendeve", ka theksuar kryeministri Hoti.

Ndërsa kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, ka ofruar mbështetjen e plotë të qeverisë shqiptare për institucionet dhe popullin e Kosovës. "Shqipëria i ka qëndruar dhe do t'i qëndrojë gjithmonë pranë Kosovës", ka deklaruar Rama, sipas Zyrës së Kryeministrit.

Në fund të këtij takimi, kryeministri Rama ka ftuar kryeministrin Hoti për një vizitë zyrtare në Shqipëri, e cila pritet të realizohet këtë të premte, më 3 korrik 2020.

Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka shkruar në profilin e vet në "Facebook" se me Edi Ramën kishte një takim vëllazëror.

Takimin e parë kryeministri shqiptar e ka realizuar me liderin e Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. Ky i fundit në llogarinë e vet në "Facebook" ka

politik në Kosovë pas situatës së krijuar në vend. "Bashkërisht konstatojmë se drejtuesit e institucioneve në Kosovë duhet të tregojnë leadership të vërtetë në këto rrethana në të cilat po kalon vendi. Është përgjegjësi e udhëheqësve të forcave politike dhe institucioneve shtetërore të Kosovës që t'i lënë anash dallimet dhe të veprojnë me gjakftohtësi të madhe në interes të vendit", ka shkruar Limaj, duke shtuar se Kosova nga kjo situatë do të dalë më e fortë se kurrë. "Kosova nuk guxon të humbasë orientimin dhe duhet t'i përgjigjemi me kujdes situatës, si dhe në të njëjtën kohë jam i bindur se ne do të dalim më të fortë nga kjo situatë. Kryeministri Rama u shpreh i gatshëm që ta ofrojë të gjithë ndihmën e shtetit shqiptar në çdo proces nëpër të cilin mund të kalojë Kosova", ka shkruar Limaj.

## Rama sot takon Mustafën, Haradinajn, Pacollin dhe Ahmetin

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, do ta ketë një agjendë të ngjeshur edhe në ditën e dytë të vizitës në Kosovë. Të martën në mëngjes, me fillim nga ora 9:00, Rama do të takohet me kryetarin e LDK-së, Isa Mustafa, me të cilin ishte paraparë të takohet të hënën, por në çastin e fundit është shtyrë takimi. Më pas, Rama do të zhvillojë takim me kryetarin e AAK-së, Ramush Haradinaj, në orën 11:00, kurse nga ora 12:00 do të takohet me Behgjet Pacollin e AKR-së, kurse një orë më vonë me kryetarin e Prishtinës, Shpend Ahmeti. Pas këtyre takimeve, kryeministri shqiptar do të deklarohet edhe për media.



PRISHTINË, 29 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka nisur të hënën një vizitë dyditore në Kosovë, pasi Gjykata Speciale ka publikuar propozimaktakuzën për presidentin e Kosovës, Hashim Thaçin dhe liderin e PDK-së, Kadri Veseli. Në ditën e parë të vizitës së tij, ai ka takuar liderët institucionalë dhe disa liderë të partive politike, me të cilët ka diskutuar për gjendjen e krijuar në vend. Pasi ka arritur në Prishtinë, kryeministri shqiptar akuzat e para të Gjykatës Speciale i ka quajtur njolla turpi për drejtësinë.

Në një postim në "Twitter", Rama ka thënë se ka ardhur në Prishtinë për të dëgjuar dhe mësuar më shumë pas njoftimit të Gjykatës Speciales për propozimaktakuzën ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe liderit të PDK-së, Kadri Veseli. "Në Prishtinë, për të dëgjuar dhe mësuar më shumë pas fletërrufesë speciale që do të hyjë si njollë turpi e shekullit XXI në historinë botërore të drejtësisë, e cila praktikën e akuzës publike pa aktakuzë juridike e ka njohur veç në epokat e sundimeve ideologjike a para tyre!", ka



detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj. Rama është takuar me presidentin Hashim Thaçi, kryeparlamentaren Vjosa Osmani, kryeministrin Avdullah Hoti, liderin LV-së, Albin Kurti, liderin e PDK-së, Kadri Veseli, liderin e Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, por pas këtyre takimeve nuk ka folur për media.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, pas takimit me kryeministrin shqiptar, ka theksuar se Kosova dhe Shqipëria i kanë të gjitha mundësitë që ta thellojnë bashkëpunimin edhe më tej. Sipas njoftimit për media të Zyrës së Kryeministrit, Hoti ka vlerësuar se Qeveria e Kosovës e



euroatlantike. "Ne jemi të vendosur ta vazhdojmë procesin e dialogut me Serbinë me qëllim që të arrijmë një marrëveshje të

shkruar se me Ramën ka diskutuar për mundësinë e koordinimit të veprimeve që duhet të ndërmarrin si spektër





PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, U ËSHTË DREJTUAR TË HËNËN QYTETARËVE PËR PROPOZIMAKTAKUZË

# GABIME POLITIKE MUND TË KEM BËRË,



## - Jap dorëheqje nëse konfirmohet aktakuza

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka mohuar pretendimet e propozimaktakuzës së Gjykatës Speciale për krime lufte. Në paraqitjen e parë për këtë çështje, shefi i shtetit ka thënë se gabime politike në paqe mund të ketë bërë, por krime lufte asnjëherë. “Edhe po të kthehesha mbrapa, në kohën e zezë të Sllobodan Millosheviqit, do të bëja të njëjtën gjë, duke iu përgjigjur plumbit armik me plumbin e etjes për liri dhe duke mos i hyrë kurrë në hak asnjë qytetari serb, rom apo shqiptar”, ka thënë ai. Presidenti Thaçi ka bërë me dije se, nëse i konfirmohet akuzat, do të japë dorëheqje. Ai e ka mbrojtur vendimin e vet për formimin e Gjykatës Speciale, duke thënë se Kosova nuk kishte rrugë tjetër

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se, nëse i konfirmohet aktakuza që ka propozuar Gjykata Speciale, do të japë dorëheqje. Në paraqitjen e parë për qytetarët, ai ka thënë se nuk do të lejojë që asnjëherë të ballafaqohet me drejtësinë nga zyra e presidentit. “Në këtë kapitull të ri e të vështirë vetëm të bashkuar mund të ecim përpara si në rrafshin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në ditët në vijim do të konsultohem me liderët politikë për hapat e mëtejshëm. Ju siguroj edhe një

herë, me drejtësinë nuk do të përballem nga kjo zyrë. Nëse aktakuza konfirmohet, unë menjëherë do të jap dorëheqje si president i juaji dhe do të përballem me akuzat”, ka thënë Thaçi në videomesazhin e publikuar në profilin e vet në “Facebook”.

Ai ka thënë se udhëheqësit e Kosovës duhet të sillen si burrshtetas të vërtetë. “Kosova është shtet i ri, por udhëheqësit e saj duhet të sillen si burrshtetas të vërtetë. Do ta mbaj këtë barrë dhe ta mbroj veten time, luftën tonë për liri, me çdo forcë që kam. Nuk do të lejoj që këto akuzat false ta zhvendosin vëmendjen e Kosovës nga marrja e vendit që meriton në bashkësinë ndërkombëtare si anëtare e Kombeve të Bashkuara, NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Kosova është atdhe i të gjithë qytetarëve të saj. Një shtet evropian me shoqëri shumetnike”, është shprehur ai. Presidenti Thaçi ka mohuar pretendimet e propozimaktakuzës. Ai ka thënë se mund të ketë bërë gabime në politikë, por asnjëherë në luftë. “Gabime politike në paqe mund të kem bërë, por krime lufte asnjëherë.

Edhe po të kthehesha mbrapa, në kohën e zezë të Sllobodan Millosheviqit, do ta bëja të njëjtën gjë, duke iu përgjigjur plumbit armik me plumbin e etjes për liri dhe duke mos i hyrë kurrë në hak asnjë qytetari serb, rom apo shqiptar. Por, një gjë më lejoni ta bëj shumë të qartë: Mbi dy dekada i kam mbështetur iniciativat për ngritjen e gjykatave me përfshirje apo mbikëqyrje ndërkombëtare. Ky parim mbetet i njëjtë edhe sot, kur jam unë, Hashim Thaçi, që personalisht do të mund të përballem me një gjykatë për të cilën kam dhënë mbështetjen time politike, me fjalë e me votë”, ka thënë ai.

Thaçi ka treguar se gjatë kësaj kohe i janë kujtuar ata që kanë dhënë jetën për liri, familja e tij dhe gjithë bashkëlufetarët e tij. “E kam kuptuar shumë herët se ne, luftëtarët e UÇK-së, do të paguanim një çmim të madh njerëzor, familjar e politik. Ky është çmimi për lirinë e Kosovës. Është e drejtë që duhet të zbardhet çdo pretendim e çdo akuzë për krime lufte, prej kujtdo dhe kudo që ka ndodhur. Bashkëlufetarët e mi, me disa prej të cilëve paqja na ka ndarë



NËN E GJYKATËS SPECIALE NDAJ TIJ

# POR KRIME LUFTE ASNJËHERË



Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Dhe, e dyta, që kjo çështje t'i lihet në dorë Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ku kanë ndikim të fuqishëm vendet që e kundërshtojnë shtetin e Kosovës. Vendimi im ishte strategjik në përputhje me vizionin për të ardhmen e Kosovës. Nuk kam shikuar për përfitime ditore e politike. Sot, kush thotë se qenkam bërë pengesë, madje edhe sabotues i kësaj gjykate, në rastin më të mirë është i keqinformuar dhe në rastin më të keq është tendencioz. Por, nga ana tjetër, dikush duhet ta bëjë bilancin e këtyre 21 vjetëve hetime, procese dhe gjykime për krimet e luftës në Kosovë", ka thënë Thaçi.

Më tej, i pari i shtetit ka thënë se do të ishte njeriu më i lumtur në botë nëse do të shihte se bashkësia ndërkombëtare aplikon standarde të njëjta mes Kosovës e Serbisë për adresimin e krimeve të luftës. "Fatkeqësisht, jo vetëm se nuk e shoh këtë standard e proporcionalitet, por shoh të kundërtën e tij. Dhe ja ku jemi sot, Serbia ecën në rrugën e negociimeve për anëtarësim evropian, ndërsa Kosova nuk gëzon të drejtën e lëvizjes së lirë. Natyrisht që unë nuk shoh këtu ndonjë komplot kundër Kosovës. Por, është fakt dallimi në qasjen e bashkësisë ndërkombëtare ndaj dy vendeve. Padyshim edhe ne kemi gabimet dhe përgjegjësitë tona. Unë i pari dhe bashkë me mua krejt udhëheqësit e partive politike në Kosovë, që prej disa vitesh nuk kemi arritur ta ruajmë kohezionin politik", ka thënë Thaçi.

Sipas tij, asnjë faj a gabim i liderëve politikë të Kosovës nuk e justifikon faktin që Kosova që 21 vjet vazhdon proceset e ballafaqimit me krime lufte në hapësirën e saj. "E, në anën tjetër, në Serbi ka rënë heshtja e varrit për krimet e luftës. Këtë heshtje të Serbisë e bën edhe më të rëndë heshtja e

bashkësisë ndërkombëtare. Ne jemi angazhuar, unë personalisht jam angazhuar fuqimisht, për dialog e paqe me Serbinë. Por, nuk pajtohem, as nuk e pranoj dot faktin që për mijëra shqiptarë të zhdukur nga makineria vrastare e Sllobodan Millosheviqit, eshtrat e të cilëve janë në dheun e Serbisë, të mos ketë as deklarata të ndërkombëtarëve. A mos vallë duhet të presim edhe ditën kur të na thuhet se duhet t'i kërkojmë falje Serbisë për të zhdukurit tanë, për nënat e motrat tona ta përdhunuar, për spastrimin etnik dhe gjenocidin kundër nesh?!", është shprehur Thaçi. Duke komentuar propozimaktakuzën e Speciales, shefi i shtetit ka thënë se ajo do të zë vend në historinë e drejtësisë dhe politikës ndërkombëtare si një faqe e zymtë e tyre për këto dy dekada.

Presidenti ka vlerësuar se ai me ish-bashkëluftëtarët e tij për këto dy dekada kanë punuar për paqe dhe drejtësi. "Unë nuk hezitova që me bashkëluftëtarët të bëj luftë me armë e me diplomaci kundër Serbisë, pa marrë parasysh çmimin që mund të paguaja, deri edhe me jetën time. Lufta ka përfunduar. Kosova është e lirë dhe shtet sovran. Prandaj në dy dekadat e fundit kam punuar dhe do të punoj për paqe dhe pajtim me Serbinë dhe në tërë Ballkanin. Sot jetoj jo thjesht për veten e për familjen time, por edhe për ata shokë që kam varrosur gjatë luftës, për prindërit dhe për fëmijët e tyre e për nipat e mbesat e tyre. Jetoj për misionin historik të cilit i përkas bashkë me Kadri Veselin, Ramush Haradinajn, Fatmir Limajn e shumë të tjerë që ishin të parët në luftën për liri, por edhe të parët të goditur e të sulmuar pas lufte", është shprehur ai.

Thaçi ka thënë se ai me ish-bashkëluftëtarët e tij nuk shkuan në luftë për të fituar

zgjedhje e as për të marrë pushtet. Sipas tij, ata shkuan për të jetuar të lirë. "Nuk kishim asgjë përveç ëndrrës së madhe për liri dhe pavarësi. Bashkërisht ëndrrën e bëmë realitet. Por, kalimi nga shtigjet e luftës çlirimtare në korridoret e institucioneve nuk mund të ishte për ne as i thjeshtë, as i lehtë. Mund t'ju them se më shumë kisha drojë nga këto korridore sesa shtigjeve të luftës. Në luftë flija pak, por gjumi më ripërtërinte. E pas luftës, flija pak po ngrihesha i silitur nga dilemat si ta bëja më mirë punën e ditës së re. Bëra sa munda, por jo aq sa do të doja. Por, sot nuk dua t'i rendis të arriturat e karrierës sime, sepse ky nuk është as një mesazh lamtumire, as një moment bilanci pune për mua. Dua vetëm t'ju them se kam mbajtur mbi kurriz shumë akuza dhe shumë ofendime gjatë tërë këtyre viteve", ka thënë ai.

## "Ligji i vetëm që kam shkelur është ai i Millosheviqit"

Presidenti në vazhdim të fjalimit është shprehur i bindur se nuk ka pasur dhe nuk mund të ketë qoftë edhe një provë të vetme në adresën e tij për shkelje të ndonjë ligji. "Ligji i vetëm që kam shkelur është ai i Millosheviqit. Unë nuk jam i rënë prej qiellit dhe nuk jam shenjtor. Fati im në rrethana krejt të veçanta historike ma përcaktoi vijën e jetës dhe të sjelljes sime", ka thënë Thaçi. Më tej, ai ka thënë se Kosova po hyn në një kapitull të ri dhe aspak të lehtë. "Ky është një kapitull i ri edhe për mua dhe në këto momente ende nuk e di se sa i vështirë do të jetë. Por, unë jam gati ta shkruaj këtë kapitull me të vërtetën time përballë kujtdo qoftë. Nuk e di a ishte rastësi apo ishte intrigë që - në mes të rrugës drejt Shtëpisë së Bardhë - doli njoftimi për një aktakuzë të

pakonfirmuar. A thua ky do të jetë çmimi i fundit që duhet paguar për lirinë e Kosovës? Rrugën ma prenë. Por, nuk ma cenonë besimin në vlerat që përfaqësojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Shtëpia e Bardhë për mua dhe për qytetarët e Kosovës", ka thënë ai, duke treguar procedurën e bërjes publike të aktakuzës. "Në praktikën e drejtësisë, në botën e qytetëruar, lajmërimi publik i një aktakuze ende të pamiruar nga trupi gjyqësor, është një skandal i madh. Asnjë krim i supozuar apo edhe i kryer nga kushdo nuk e justifikon linçimin publik. Asnjë qëllim i mirë dhe asnjë vullnet i madh për drejtësi nuk e arsyeton fabrikimin e një bombe mediatike për ta inkriminuar të parin e shtetit të Kosovës, pikërisht në momentin kur dialogu me Serbinë kishte hyrë në një fazë të re falë angazhimit të drejtpërdrejtë të Shtëpisë së Bardhë", është shprehur ai. Sipas tij, kjo shkelje flagrante e rregullave të një procesi të drejtë e të pavarur gjyqësor dëmton procesin e dialogut Kosovë - Serbi. "Ajo komunikatë hodhi në erë dhe pamundësoi takimin shumë të rëndësishëm në Shtëpinë e Bardhë, duke i dhënë goditje të fortë mundësisë së arritjes së paqes Kosovë - Serbi. Prandaj apeli me të cilin dua ta mbyll këtë mesazh sonte është: Kosova duhet ta sigurojë funksionimin stabil të institucioneve shtetërore në çdo rrethanë. Në këtë kapitull të ri e të vështirë vetëm të bashkuar mund të ecim përpara, si në rrafshin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar", ka thënë ai, duke vlerësuar se është kundër hakmarrjes. "I them edhe një herë jo hakmarrjes dhe po tolerancës ndëretnike. Vetëm duke ndërtuar demokracinë qytetare ndërtojmë të ardhme euroatlantike", ka deklaruar Thaçi.

## Hoti: Do të reagojmë me dinjitet karshi zhvillimeve që priten

PRISHTINË, 29 QERSHOR (ER)- Kosova do të reagojë me dinjitet ndaj zhvillimeve të mundshme në ditët e ardhshme, të cilat ndërlidhen me aktakuzën e paraqitur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, me seli në Hagë, në Dhomat e Specializuara, kundër presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. Kështu ka deklaruar të hënën kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti.

Në një konferencë për media, ai

ka komentuar se cilat do të jenë rrjedhat politike në rast se presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi jep dorëheqje, si dhe pas kësaj, eventualisht, a do të synohet bashkëpunimi i qeverisë aktuale me Partinë Demokratike të Kosovës për të bërë zgjedhjen e presidentit të ri. "Unë besoj që pas gjithë këtyre viteve kemi ndërtuar një kulturë institucionale dhe një maturi institucionale. Me cilado situata

që përballemi do të reagojmë me dinjitet karshi zhvillimeve që do të ndodhin", ka theksuar Hoti. Duke komentuar kërkesën e vazhdueshme të partisë më të madhe opozitare në Kuvendin e Kosovës, Lëvizjes Vetëvendosje, për zgjedhje të reja të parakohshme parlamentare, Hoti ka theksuar që qeveria aktuale do të vazhdojë punën edhe më tej. "Sa u përket zgjedhjeve, Kosova ka qeveri

plotësisht funksionale dhe kushtetuese dhe për aq kohë sa është një qeveri që është funksionale, që ka mbështetjen e shumicës së deputetëve në Kuvendin e Kosovës, duhet të vazhdojë", është shprehur Hoti. Javën e kaluar, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka njoftuar se më 24 prill u ka dërguar Dhomave të Specializuara të Kosovës, me seli në Hagë, një aktakuzë me dhjetë pika për shqyrtim, në të cilën



Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe të tjerë akuzohen për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.



## Kuvendi i kërkon IKShPK-së testimin e stafit për Covid-19

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Kuvendi i Kosovës i ka bërë kërkesë Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) që ta shohë mundësinë e testimit për Covid-19 të zyrtarëve dhe deputetëve të këtij institucioni. Kështu ka bërë

me dije për "Rel" sekretari i përgjithshëm në Kuvendin e Kosovës, Ismet Krasniqi, i cili ka rezultuar pozitiv me Covid-19. "Me pranimin e rezultatatit të testit, e kam njoftuar stafin dhe jam izoluar", ka thënë ai. Krasniqi ka theksuar se

IKShK-ja nuk ka kthyer ende përgjigje sa i përket testimit të stafit të Kuvendit.

Edhe shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Arben Gashi, ka njoftuar të dielën se ka rezultuar poziti-

tiv me Covid-19, bashkë me anëtarët e tjerë të familjes. Përndryshe, Kryesia e Kuvendit të Kosovës e ka shtyrë mbledhjen e paralajmëruar për të hënë për një ditë tjetër. Në njoftimin e Kuvendit nuk përmendet arsyeja e shtyrjes.



# Haziri: Nëse rriten rastet e përhapjes me Covid-19 i ashpërsojmë të masat

"Nëse vazhdon kështu trendi i përhapjes së infeksionit, unë jam për ashpërsim të masave", ka thënë të hënë, në një konferencë për media, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri. Ai u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve për kujdes maksimal ndaj vetvetes, familjes, fëmijëve e pleqve, duke zbatuar masat mbrojtëse



**EPOKA E RE**

F. DËRMAKU

GJILAN, 29 QERSHOR - Në ditën e 109 të përballjes me Covid-19, Komiteti për Menaxhimin e Situatave, i ngritur në nivelin e shkallës së dytë të rrezikshmërisë në Komunën e Gjilanit, ka vlerësuar gjendjen në të cilën është kjo komunë në aspektin e shëndetit publik, si dhe janë analizuar burimet e fundit të cilat kanë rezultuar pozitiv në test e që lidhen me burime në vendin e punës.

Në fjalën e tij para gazetarëve, kryetari i komunës, Lutfi Haziri, pas takimit që kishte me komitetin, ka deklaruar se rastet e fundit në Gjilan kontaktin me infeksionin e kanë nga vendet e tyre të punës në institucionet dhe detyrat zyrtare shtetërore, por edhe nga puna në sektorin privat. "Angazhimi në menaxhimin e rasteve pozitive në Gjilan është i vazhdueshëm përmes ekipeve mjekësore, monitorimin nga inspektorët komunalë dhe punën e madhe

që e bënë policia dhe institucionet e tjera përgjegjëse. Deri më tani janë testuar nga Qendra Rajonale e Shëndetit Publik 1 442 qytetarë, prej të cilave raste aktive i kemi 71, të shëruar 91, nga jeta janë ndarë tre qytetarë të cilët kishin edhe probleme të tjera shëndetësore", ka thënë Haziri në konferencë me gazetar.

Ai ka potencuar se pikë e zezë në pandemi mbetet edhe më tutje vdekja e Agon Musliut, në karantinë në Prishtinë, e cila lidhet me zhvillimet e pandemisë dhe presim që hetimet ta zbardhin rastin e tij deri në fund. Gjithashtu, ai ka konfirmuar se inspektorët e Komunës së Gjilanit janë duke punuar për respektimin e rekomandimeve shëndetësore, atyre të Komitetit të Emergjencave dhe manualit që e ka nxjerrë Ministria e Shëndetësisë dhe e njëjta kërkohet edhe nga qytetarët.

I pari i Gjilanit u ka bërë thirrje qytetarëve për kujdes maksimal ndaj vetvetes, familjes, fëmijëve e pleqve,

duke zbatuar masat mbrojtëse, mbajtjen e distancës, duke i llogaritur këto pjesë të jetës dhe kulturës së të jetuarit, në vende publike, rrugë, punë dhe kudo që të jemi.

Ai ka paralajmëruar masa rigorozë në Gjilan nëse vazhdon trendi i infektimit në

rritje. "Nëse vazhdon kështu trendi i përhapjes së infeksionit, unë jam për ashpërsim të masave. Po punojmë vazhdimisht me këtë ekip, me këshillat e fshatrave dhe me institucionet e tjera publike, që të mos vijë deri aty. Kemi bërë përgatitjen për pritjen e bashkatdhetarëve, janë hapur

të gjithë kufijtë, aeroporti dhe kufijtë tokësorë. Gjatë kësaj jave me kërkesën tonë do të hapet edhe pika kufitare Stançiq - Bellanoc. Të shkojmë drejt normalizimit, por me masa shtesë të kujdesit dhe shpresojmë shumë në normalizim të plotë", ka theksuar kryetari Haziri.

## Më 1 korrik hapet Pishina e Gërmisë, numri i vizitorëve do të jetë i kufizuar

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Më 1 korrik në Prishtinë pritet të hapet Pishina e Gërmisë. Udhëheqja e Ndërmarrjes Publike "Sport Marketing", e cila e menaxhon këtë pishinë, ka thënë se i ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për t'i respektuar rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Kryeshefi ekzekutiv i kësaj ndërmarrjeje, Liridon

Llaspashtica, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se qytetarët do të jenë të sigurt nga infektimi gjatë vizitës në pishinë. "Kemi angazhuar stafin profesional, duke filluar nga sigurimi fizik që është vendosur në hyrje të pishinës, pastaj shpëtimtarët, auto-ambulanca me mjekun dhe teknikun si dhe mirëmbajtësit. Vlen të theksohet se edhe uji do të jetë në nivel për nga pastërtia, pasi kemi filluar javë më parë me klorifikimin e ujit. Madje vlen të

theksohet se klori është element kimik vrasës i viruseve dhe baktereve të ndryshme", ka thënë Llaspashtica.

Ai ka treguar edhe masat që janë ndërmarrë për ta siguruar distancën fizike në pishinë. "Pishina e Gërmisë ka hapësirë prej 5 hektarësh, pra është sipërfaqe shumë e madhe. Kemi vendosur që edhe çadrat të jenë në distancë prej 2 metrash. Pra, kemi hapësirë të mjaftueshme që t'i presim qytetarët e Prishtinës, që këto

ditë të nxehta t'i kalojnë duke u freskuar në pishinën e Gërmisë", ka thënë ai.

Noti në pishina të mirëmbajtura dhe të klorifikuara mirë pretendohet të jetë i sigurt. Megjithatë, Organizata Botërore e Shëndetësisë i këshillon shfrytëzuesit e pishinave që t'u shmangen turmave, përfshirë këtu edhe ato në pishina dhe ta respektojnë distancën fizike. Problematike në përpjekjet për parandalimin e përhapjes së koronavirusit mbeten



hapësirat e përbashkëta përreth pishinës, siç janë zhveshtoret, tualetet publike dhe restorantet. Llaspashtica ka theksuar se në Pishinën e Gërmisë do të lejohet numri i kufizuar i vizitorëve, bazuar në respektimin e distancës fizike.



MBAHET TAKIMI I KOMITETIT PËR KOORDINIMIN DHE VLERËSIMIN E SITUATËS EMERGJENTE ME COVID-19

# Pas rritjes së numrit të të infektuarve me Covid-19, qeveria paralajmëron kthim të masave



**Kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se, për shkak të rritjes së numrit të të infektuarve me Covid-19, do të fillojnë kthimin e disa prej masave. Ai ka bërë me dije se, varësisht nga rezultatet, do ta vazhdojnë marrjen e masave të reja në kuadër të Komitetit për koordinimin dhe vlerësimin e situatës emergjente me Covid-19. Sipas tij, institucionet e Kosovës duhet të punojnë vetëm me staf esencial, do të mbyllën sektorët në të cilët ka raste të paraqitura me infeksion, duhet të ketë kontrolle rigorozë për të infektuarit që të mbahen në izolim dyjavor dhe inspektorati sanitar duhet të marrë masa në përputhje me ligjin**

mjekë që janë vija e parë e frontit në përballje me Covid-19. Të gjithë jemi të rrezikuar, të gjitha institucionet janë të rrezikuara dhe duke qenë të rrezikuara në institucione, biznese e në rrugë, ne rrezikim e çojmë në shtëpi, te fëmijët tanë, te prindërit tanë. Situata është nën kontroll, nën kontroll të brishtë. Duhet të punojmë shumë të gjithë së bashku për ta mbajtur situatën nën kontroll dhe për t'i menaxhuar rastet të cilat janë duke u paraqitur", ka thënë ai.

Kryeministri Hoti ka thënë se në këtë takim kanë diskutuar për masat që do t'i ndërmarren menjëherë qysh në mbledhjen e ardhshme të qeverisë nëse ka nevojë për vendime ekzekutive, duke filluar nga reduktimi i stafit në institucione për të gjithë ata që kanë mundësi ta kryejnë punën nga shtëpia duhet të kujdesen bartësit e institucioneve që t'i lirojnë ata në shtëpi. "Do të mbyllën menjëherë të gjithë sektorët, departamente të ndryshme, në biznese ose në institucione ku ka raste të paraqitura. Duhet, përmes organeve të rendit, të kontrollohen që personat që janë të infektuar të mbesin të izoluar. Ata paraqesin rrezik për qytetarët e tjerë. Duhet të aktivizohen menjëherë shtabet lokale të komunave. Shumë nga komunat i kanë aktive, por duhet ta ngrehin nivelin e aktivizimit të tyre", është shprehur ai.

Hoti ka shtuar se janë në diskutim nëse duhet të ndërmarren masa për karantinimin e disa prej lokacioneve, ku ka më së shumti

raste të paraqitura me Covid-19. "Do ta ndalojmë grumbullimin e personave, qytetarëve në hapësira të hapura apo të mbyllura për më shumë se 100 persona në çdo situatë. Duhet t'i rregullojmë pak më mirë ceremonitë mortore, vetëm me rrethin e ngushtë familjarë, ashtu siç kanë qenë të rregulluara më herët", ka deklaruar kryeministri Hoti.

Ndërkaq ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se ministria që drejton me të gjitha potencialet që ka është duke u angazhuar për menaxhimin e situatës, duke përfshirë edhe shërbimet e tjera shëndetësore që janë nevojë e qytetarëve të republikës sonë. "Duke qenë që ne jemi tashmë në fazën e III-të të hapjes graduale ekonomike dhe shumica e veprimtarive janë lejuar, kjo ka rezultuar edhe me një rritje të numrit të rasteve pozitive në Covid-19 që nuk mund të thuhet se ishte e papritur por që, për fat të keq, ka rezultuar me rritje të numrit të pacientëve që kërkojnë tretman spitalor në Klinikën Infektive. Kjo si pasojë e mosrespektimit të masave të ndërmarra, mosrespektimit nga ana e bizneseve dhe veprimtarive të tjera të lejuara, por edhe nga qytetarët si dhe mosrespektimit të manualit për mbrojtje nga përhapja e Covid-19", ka thënë Zemaj.

Ai ka thënë se mosrespektimi i masave tregon se mirëbesimi i nënkuptuar si kusht për hapje midis institucioneve, bizneseve dhe qytetarëve nuk është përkthyer në përgjegjësi pas

vendimeve për hapje të plotë dhe lirimit të veprimtarive të ndryshme. "Me qëllim që t'i japim një shans më shumë dhe më tepër frymëmarrjes së bizneseve të dëmtuara nga pandemia, së fundi ne hapëm edhe linjat e rregullta të fluturimeve ajrore nga dita e djeshme si dhe planifikohet të hapen edhe veprimtaritë e tjera. Por, nëse hapja e këtyre veprimtarive dhe të tjerave nuk shoqërohet në të njëjtën kohë me rritje të përgjegjësisë në zbatimin e masave, ngritjen e monitorimit në një nivel më të lartë nga të gjitha institucionet mbikëqyrëse dhe zbatuese, siç janë inspektoratet, dilema që do të shtrohet para nesh do të jetë se a ia vlen hapja e mëtejme dhe marrja e masave të cilat i përmendi kryeministri i Republikës së Kosovës", ka thënë ai.

Ministri Zemaj ka bërë me dije se kanë kërkuar nga institucionet relevante për menaxhimin e pandemisë që masat të cilat janë vënë nga MSh-ja dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe janë bërë obliguese nga Qeveria e Republikës së Kosovës të zbatohen. "Ministria e Shëndetësisë me të gjitha kapacitetet dhe institucionet përkatëse po bën çmos që të mos kemi rikthim të asnjë mase të izolimit. Andaj, ju lutem, na ndihmoni. Zbatoheni rekomandimet, mbani maskat, mbani distancë, mbani higjienën që të ecim përpara dhe të shkojmë drejt lirisë së plotë ekonomike të lëvizjes dhe rikthimit në normalitet", ka deklaruar ministri Zemaj.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, kanë marrë pjesë të hënën në takimin e Komitetit për koordinimin dhe vlerësimin e situatës emergjente me koronavirus. Pas takimit, kryeministri Hoti dhe ministri Zemaj kanë mbajtur konferencë për media, në të cilën kanë thënë se është diskutuar në detaje me të gjithë bartësit e institucioneve për gjendjen në të cilën po kalon vendi, në veçanti gjatë ditëve të fundit. "Më lejoni të them shumë qartë dhe drejt para jush dhe para të gjithë qytetarëve se nuk mund të lejojmë që gjendja të dalë jashtë kontrollit. Jeta e qytetarëve është mbi të gjitha. Është prioriteti ynë i parë. Kemi 49 raste me fatalitet. Klinika Infektive është e stërmbushur, nuk ka vende më për njerëz në

Klinikën Infektive. Tash ministri dhe drejtori i Institutit, drejtori i QKUK-së, janë duke krijuar hapësira shtesë nëpër klinikat e tjera, edhe nëpër spitale regjionale", ka thënë Hoti. Ai ka theksuar se masat janë shumë të thjeshta dhe shumë të qarta: maskat, distanca fizike, larja e duarve. "Tri masa të thjeshta, të cilat jemi të obligueshëm që të gjithë t'i ndërmarim", ka pohuar ai.

Hoti ka thënë se çdokush që nuk i zbaton këto masa bën vepër penale, sepse rrezikon shëndetin e vet, jetën e vet dhe të qytetarëve të tjerë. "Deri sot kemi pasur 2 677 raste me Covid-19. Për momentin i kemi 113 persona që janë të shtirë, gjashtë janë në gjendje të rëndë shëndetësore. Staf i shëndetësor është duke e bërë maksimumin. Nëse i shihni shifrat se kush ka qenë më së shumti i prekur nga këto raste me të infektuar deri më sot, del se 8 për qind të rasteve totale janë



# Diplomojnë 15 kadetë të FSK-së, në mesin e tyre edhe djali i heroit Shkëlzen Haradinaj, Luani

**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të hënën është mbajtur ceremonia ushtarake e diplomimit të kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së të gjeneratës së studimeve gjatë periudhës 2016-2020.

Në ceremoninë e organizuar me pjesëmarrje të kufizuara për shkak të masave kundër Covid-19 morën pjesë ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, ish-kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), gjeneralbrigade Frank Best, u. d. sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Faruk Geci, stafi i lartë ushtarak dhe civil i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së, atashë ushtarakë të vendeve partnere, oficerë të NALT-it, këshilltarët ushtarakë bilateralë, si dhe familjarë të kadetëve të diplomuar.

Pas nderimit të flamurit, me fjalë përshëndetëse të pranishmëve iu drejtua, nikoqirja e ceremonisë, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), komandë brenda së cilës vepron edhe QSU, gjeneralbrigade Irfete Spahiu.

Gjeneral Spahiu, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, ua rikujtoi kadetëve rrugëtimin e përbashkët me të gjitha strukturat e komandës që udhëheq për ta realizuar arritjen e standardeve më të larta profesionale dhe akademike me programin tejet sfidues për përgatitje psikike, fizike, profesionale dhe intelektuale. Ajo në mesazhin e

urimit shprehu besimin për sukseset e kadetëve edhe në vazhdim të karrierës së tyre si oficerë ushtarakë, gjithnjë me moton "E ardhmja fillon këtu". "Po bëhen më shumë se dy dekada nga koha kur populli i këtij vendi u çlirua dhe më shumë se dy dekada kur unë vendosa të bëhem pjesë e ushtrisë, por ajo çka nuk ndryshon asnjëherë te një ushtarak është për të kontribuar për atdhe dhe jo vetëm në kohë lufte, por edhe në paqe", ka thënë ajo.

Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, në mesazhin e tij drejtuar kadetëve të diplomuar, i inkurajoi të qëndrojnë konsistentë në realizimin e synimeve me frymën dhe shpirtin luftarak gjithmonë duke ruajtur prestigjin e FSK-së dhe vlerat themelore të ushtarakut, si detyrën, nderin dhe atdheun. "Detyra, nderi dhe atdheu janë vlerat që do t'ju vendosin nga kjo ditë në shërbim të të gjithë qytetarëve pa dallim, vlera këto që janë tashmë të ngulitura në zemrat tuaja", ka thënë gjeneral Rama.

Ai, gjithashtu, shprehu falënderimin për partnerët tanë të cilët, me mbështetjen e madhe, mundësuan zhvillimin dhe avancimin e QSU-së me programe të akredituara në gjuhën angleze sipas standardeve më të avancuara të vendeve partnere, anëtare të NATO-s, për çka edhe kanë ofertën e hapur për të sjellë kandidatë të tyre për studime në qendrën tonë.

Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, në adresimin e tij para të pranishmëve iu drejtua kadetëve të diplomuar duke i theksuar me emra të përveçëm. "Jo pa qëllim po ritheksoj emrat tuaj. Dua këta emra t'i dëgjoj çdo qytetarë dhe të kuptohet se



## Haradinaj, i gëzuar që i diplomoi nipi në FSK

Në mesin e 15 kadetëve që diplomuan ishte edhe djali i vëllait të Ramush Haradinajt, Luan Haradinaj. "Gjithçka sot i takon një ushtrie moderne,

tamam një ushtrie të NATO-s. E gjithë ceremonia. Gjeneratës 2020, shumë urime! Kuptohet se sot jemi edhe si familjarë së bashku

me Suzanën, sepse Luani ka diplomuar dhe jemi jashtëzakonisht të gëzuar", ka thënë ish-kryeministri Haradinaj.

pse ju jeni të veçantë dhe pse ky moment është i veçantë", është shprehur ministri Quni. Si ish-ushtarak karriere, ministri Quni ua rikujtoi kadetëve rrugëtimin me përplot sprova e sfida gjatë studimeve si testet e stërvitjet për qëndrueshmëri morale e kalitje fizike, përballja me kushtet e mbijetesës, marshimet e gjata e të mundimshme e deri te leksionet e provimet e shumta profesionale e akademike

gjithnjë me të jetuar nën regjimin e repret të disiplinës ushtarake.

Duke shprehur besimin e plotë në suksesin dhe fitoren e garantuar të tyre për përmbushjen e misionit gjatë shërbimit si lider ushtarak, ai tha kjo do të arrihet nga ju gjithmonë sepse udhëhiqeni nga vlerat e shenjta të ushtarakut, detyrës, nderit dhe atdheut. "Unë besoj se ju edhe më shumë do t'i forconi urat e miqësisë me ShBA-në dhe partnerët e tjerë strategjikë. Falënderimi dhe mirënjohja është dhe do të jetë e përjetshme për NATO-n dhe miqtë tanë që në kohët më të vështira na qëndruan pranë. Prandaj përgatituni që të zbarkoni edhe jashtë vendit që me gatishmërinë tonë profesionale dhe morale t'i shërbejmë njerëzimit dhe paqes kudo që ka nevojë. Çdo kund dhe në çdo kohë barteni në vete dashurinë e Nënës Terezë, urtësinë e presidentit Rugova dhe guximin, trimërinë dhe sakrificën e Adem Jasharit dhe familjes Jashari", ka deklaruar ministri Quni.

Në fund, ai theksoi se synimi ynë strategjik është anëtarësimi në NATO dhe shprehu bindjen e plotë se me kuadro të këtilla, pavarësisht prej sfidave gjeopolitike të çastit, e ardhmja euroatlantike e vendit është e sigurt.

Ceremonia vazhdoi me ndarjen e diplomave për 15 kadetët e diplomuar nga ana e ministrit Quni, gjeneral Ramës dhe gjeneral Spahiut. Në mesin e të diplomuarve ishte edhe djali i heroit Shkëlzen Haradinaj, Luani. Po ashtu, në mesin e të diplomuarve ishte edhe kadetja nga Republika e Shqipërisë, Lirza Dollomaja, e cila, bazuar në rezultatet dhe performancën e dëshmuar, u dekorua edhe si "Kadetja më e dalluar" e gjeneratës 2020, ndërsa me motivacionin e njëjtë u dekorua edhe "Instruktori më i dalluar" i QSU-së, toger Shpend Halimi. Në emër të kadetëve të diplomuar me një fjalë rasti të pranishmit i përshëndeti kadetja Dollomaja, e cila tha se me vendosmëri të madhe arritën suksesin dhe se si oficerë do të jenë në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit kudo në botë.





# Shtyhet deri më 15 gusht dorëzimi i deklarimeve në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Ministria e Financave ka marrë vendim që ta shtynë deri më 15 gusht dorëzimin e deklarimeve në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar. Sipas MF-së, kjo bëhet për arsye të vështirësive që bizneset kanë pasur gjatë pandemisë Covid-19. "Në mbështetje të Rregullores për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe me qëllim të zbatimit të masave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për luftimin e

pandemisë Covid-19, duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka marrë vendim për: 1. Shtyrjen e afatit deri më 15 gusht 2020 për dorëzimin e deklarimeve në Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar (KKRF); 2. Shtyrjen e afatit deri më 15 gusht 2020 për dorëzimin në KKRF për publikim të pasqyrave vjetore financiare; 3. Shtyrjen e afatit deri më 15 gusht 2020 për dorëzimin në KKRF të pasqyrave financiare vjetore, respektivisht pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raportin e rishikimit të



pasqyrave vjetore financiare të konsoliduara nga shoqëritë tregtare; 4. Shtyrjen e afatit deri

më 15 gusht 2020 për dorëzimin e pasqyrave financiare të audituara në pajtim me SNA-të,

në KKRF dhe publikimi i tyre, si dhe dorëzimi i tyre në Ministrinë përkatëse për tregti dhe industri; 5. Shtyrjen e afatit deri më 15 gusht 2020 për dorëzimin në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe në KKRF të pasqyrave për pozitën financiare, llogaritë e fitimit dhe humbjeve si dhe informatat shitesë lidhur me vitin paraprak kalendarik për qëllime statistikore dhe qëllime të tjera; 6. Shtyrjen e afatit deri më 15 gusht 2020 për raportimin vjetor të Shoqatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Financave.

## UNDP-ja konfirmon vazhdimin e përkrahjes për Kosovën



PRISHTINË, 29 QERSHOR (ER) - Ministria e Financave, Hykmete Bajrami, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesen e përhershme të UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko. Në takim u bisedua për situatën socio-ekonomike në vendin tonë si dhe për bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së Financave dhe UNDP-së në projekte të ndryshme. Ministria Bajrami ka falënderuar

Suokko dhe UNDP-në për angazhimin dhe kontributin e tyre në Kosovë, veçanërisht për ndihmën e UNDP-së ndaj Ministrisë së Financave gjatë pandemisë Covid-19. Ajo ka shprehur gatishmërinë e Ministrisë së Financave për thellimin e bashkëpunimit në projekte të përbashkëta që kanë për qëllim avancimin e qeverisjes së mirë, rritjes së transparencës dhe të

mirëqenies së qytetarëve të Kosovës.

Ndërsa përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko, duke uruar ministren Bajrami për pozitën e re në krye të Ministrisë së Financave, ka shprehur gatishmërinë e UNDP-së për vazhdimin e përkrahjes së Kosovës në ndërtimin e një të ardhme të qëndrueshme për të gjithë.

## Nënshkruhet marrëveshja me Bankën Botërore në vlerë prej 46 milionë eurosh për luftimin e Covid-19

EPOKA  
ERE **A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Ministria e Financave, Hykmete Bajrami, ka nënshkruar të hënën marrëveshjen e kredisë me Bankën Botërore përmes Asociacionit Zhvillimor Ndërkombëtar në vlerë prej 46 milionë eurosh për "Projektin emergjent Covid-19 për Kosovën". Kjo ministri ka bërë me dije se

mjetet financiare do të destinohen për parandalimin, zbulimin dhe reagimin ndaj kërcënimit të paraqitur nga Covid-19, duke mundësuar prokurimin e pajisjeve mjekësore si dhe forcimin e sistemit shëndetësor publik me qëllim të rritjes së kapaciteteve të testimit dhe zgjerimit e kapaciteteve të Klinikës Infektive. Në kuadër të kësaj kredisë do të mbështeten skemat e ndihmave sociale dhe

amvisëritë sipas pakos së kaluar dhe Programit për Rimëkëmbje Ekonomike të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Asociacioni Zhvillimor Ndërkombëtar, si pjesë e Bankës Botërore, është institucion kredihënës, i cili, përmes huadhënies në kushte më të favorshme sesa të tregut financiar, synon të ndihmojë, ndër të tjera, reduktimin e varfërisë dhe përmirësimin e kushteve jetësore.



## Krasniqi dhe Tolaj koordinohen për procesin e privatizimit

PRISHTINË, 29 QERSHOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur të hënën në takim drejtorin menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Valon Tolaj, me

bashkëpunëtorë, ku temë e bisedës ishte koordinimi institucional për zbatimin e normativave në procesin e privatizimit. Sipas njoftimit të MTI-së, në këtë takim u diskutua edhe për

bashkëpunimin institucional në mes të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) në kuadër të legjislacionit në fuqi për çështjet me interes të zhvillimit të ndërmarrësisë së

Kosovës. Ministri Krasniqi ka shprehur gatishmërinë e tij për bashkëpunim me AKP-në, për t'i trajtuar të gjitha çështjet që prekin fushat me interes ekonomik të vendit gjatë procesit të privatizimit.





## “Llapusha” fillon ndërtimin e parkingut te varrezat e fshatit Tërpezë

**MALISHEVË, 29 QERSHOR (ER)** - Grupi i Veprimit Lokal (GVL) “Llapusha” në Malishevë ka filluar realizimin e projektit për ndërtimin e parkingut përreth varrezave në fshatin Tërpezë të Malishevës. Ky projekt është në interes të banorëve të fshatit dhe është një prej qëllimeve apo fushëveprimeve që ka GVL “Llapusha”.

Koordinatori i projektit, Halit Mazreku, ka thënë se synojnë t’i zhvillojnë ekonomisht zonat rurale të Malishevës. “Qëllimi kryesor i GLV-ve është që të kontribuojë për zhvillim-

in ekonomik të zonave rurale, duke i ofruar përkrahje komunitetit rural për përgatitjen dhe zbatimin e strategjive zhvillimore në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin lokal”, ka thënë Mazreku. Ndërtimi i parkingut te varrezat e fshatit Tërpezë financohet nga GVL “Llapusha” me rreth 60 për qind të shumës së projektit, 20 për qind pas përfundimit e mbulon Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të strategjisë për zhvillim rural. I tërë projekti kap një shumë prej 4 953 eurosh.



## Miratohet plani zhvillimor komunal në Drenas

**DRENAS, 29 QERSHOR (ER)** - Në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të hënën është miratuar me vota unanime plani zhvillimor komunal për periudhën 2020-2028.

Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka thënë se ky dokument i planifikimit hapësinor paraqet një bazë të mirë për zhvillimin komunal. “Plani Zhvillimor Komunal është një pasqyrë e zhvillimit të Komunës së Drenasit dhe është një plan strategjik multi-sektorial i cili

përcakton periudhën afatgjatë tetë vjet të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Deri në miratimin e këtij dokumenti janë ndjekur të gjitha fazat e diskutimeve me qytetarë e grupe të interesit për të qenë sa më transparent. Fazat që ka kaluar procesi i PZHK-së janë profili, vlerësimi i gjendjes ekzistuese, koncepti i zhvillimit hapësinor dhe prioritetet strategjike me planin e veprimit. Të gjitha këto faza janë përcjellë me pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe aktorëve të tjerë relevantë”, ka



thënë Lladrovci.

Ai ka falënderuar kontribuuesit e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Drenasit 2020-2028. Sipas Lladrovci, ky falënderim iu dedikohet ekspertëve nga GIZ-i gjerman, ekspertëve të kompanisë hartuese të PZHK-së, Ekipit Komunal për Planifikim, Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, Ekipit Këshillues të Komunitetit si dhe të gjithë qytetarëve dhe grupeve të interesit që kanë marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti.



## Komuna e Mitrovicës vendos për ndalimin e drekave zyrtare

**MITROVICË, 29 QERSHOR (ER)** - Komuna e Mitrovicës ka njoftuar se ka marrë vendim për ndalimin e drekave dhe zyrtare të drejtorive komunale. Nëpërmjet një komunikate drejtuar mediave, kjo komunë ka bërë me dije se ky vendim është marrë me qëllim të kursimit të mjeteve buxhetore në mënyrë që këto mjete të dedikohen në

të mirë të qytetarëve. “Gjatë këtij takimi kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka marrë vendim që t’ua ndalojë të gjitha drejtorive komunale shpenzimet për dreka dhe darka zyrtare, me qëllim të kursimit të mjeteve buxhetore, në mënyrë që këto mjete të dedikohen në të mirë të qytetarëve”, është thënë në komunikatën e Komunës së Mitrovicës.

## 2 400 familje gjakovare janë ndihmuar gjatë pandemisë

**GJAKOVË, 29 QERSHOR (ER)** - Gjatë mbledhjes së katërt të Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, Ferdinand Kolaj, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, ka bërë me dije se që nga shpallja e pandemisë Covid-19 e deri më sot në këtë komunë rezultojnë rreth pesëdhjetë persona të infektuar me koronavirus. Aktualisht, pas zbutjes së masave, respektivisht pas heqjes së masave restriktive, aktivë janë mbi tridhjetë

raste. Ndërkohë, vetëm një person gjatë muajit prill ka përfunduar me vdekje. Përpos masave të ndërmarra, Kolaj ka njoftuar se deri më tani me pako me ndihma janë ndihmuar mbi 2 400 familje. Nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim është dhënë informata mbi fillimin e fushatës për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë ku, përpos fëmijëve të komunitetit RAE, janë të përfshirë edhe fëmijët e tjerë të riatdhesuar.





# PROMOTORËT E LIRISË



**Shkruan: Ramadan AVDIU**

Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin i kam njohur në valën e protestave të fuqishme antipushtuese në mars të vitit 1989. Unë sapo isha liruar nga burgu, kurse ata kishin filluar studimet në Universitetin e Prishtinës dhe ishin rreshtuar në Rrugën e Lirisë. Pra, më shumë se 31 vjet në angazhim për liri, pavarësi, e demokraci, në rezistencë antipushtuese, në luftë, vetëmohim dhe shtetndërtim jam bashkë me Hashimin dhe Kadriun dhe kështu do të jem deri në frymën e fundit sepse e di që me të njëjtin elan që kanë luftuar për liri, po me atë elan e përkushtim ata kanë punuar edhe për shtetndërtim dhe demokratizim të shoqërisë.

Në fund të Luftës së Dytë Botërore Gjkata Ndërkombëtare në Nyrnberg, përveç nazistëve, nuk ka dënuar asnjë pjesëtar të asnjë kombi që luftoi kundër nazizmit. Në mënyrën më të denjë nazizmi është inkarnuar në shtetin e Serbisë e cila pastaj, me të njëjtat metoda, vazhdoi ushtrimin e gjenocidit mbi popullin shqiptar që e kishte filluar në mes të dy luftërave botërore.

Serbia nga viti 1945 e deri më 1998 kishte vrarë qindra mijëra shqiptarë, burgosur dhjetëra

mijëra të tjerë dhe mbi një milion të dëbuar në Turqi dhe nëpër vende të ndryshme të botës.

Vetëm lufta çlirimtare e organizuar nga Ushtria e Lavdishme Çlirimtare e Kosovës, e mbështetur edhe nga shtetet demokratike, e ndali Serbinë në synimin e saj për nënshtrimin apo edhe zhdukjen e shqiptarëve si komb dhe si popull.

Edhe gjatë luftës çlirimtare Serbia ushtroi gjenocid të paparë mbi popullin shqiptar, (mbi 13 500 civilë të vrarë, 1 392 fëmijë, 1 739 gra të vrara, mbi 1 600 persona akoma llogariten të zhdukur sepse Serbia refuzon t'i tregojë vendet ku i kanë fshehur kufomat e tyre, mbi 20 mijë gra e vajza të dhunuara, mbi 1 milion shqiptarë të dëbuar, mbi 50 për qind e objekteve të shkatërruara, e gjithë pasuria e plaçkitur, tërë ekonomia e rrënuar). Për këtë gjenocid kundër popullit shqiptar nuk po dënohen kriminelët e vërtetë të regjimit serb. Pikërisht për shkak të pandëshkueshmërisë së kriminelëve serbë për gjenocidin e kryer, ata janë inkurajuar dhe tashmë kanë paturpësinë edhe të kreken për krimet e tyre... apo nganjëherë edhe të hiqen si viktime...

Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli ishin promotorët e organizimit të luftës çlirimtare dhe mbrojtjes së popullit nga gjenocidi që po ushtrohej mbi të, ishin promotorët edhe të ndërtimit të shtetit të Kosovës dhe demokratizimit të tij. Andaj pretendimi se ndaj tyre duhet ngritur përgjegjësi penale është absurd, anakronik dhe antihistorik.

Dhomat e specializuara të

gjykatës, të krijuara nga Kuvendi i Kosovës si rezultat i presionit ndërkombëtar, me publikimin e kumtesës mbi pretendimet e prokurorit për ta ndjekur penalisht presidentin e shtetit Hashim Thaçi dhe kryetarin e PDK-së, Kadri Veseli, para se të miratohet procedura paraprakisht akuza, ka nxjerrë në pah jokarakterin e një instrumenti të drejtësisë, por karakterin e një instrumenti që po përdoret për qëllime politike. Prandaj Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta rishqyrtojë vendimin e tij dhe të mos ua vazhdojë mandatin dhomave të specializuara të gjykatës sepse ato po dëshmojnë që nuk janë të specializuara për drejtësi, por për të krijuar një precedent të rrezikshëm dhe në vend të ndëshkimit të Serbisë për gjenocid të kryer kundër popullit shqiptar, ata përpiqen të shpër-

dajnë përgjegjësi edhe tek ata që luftuan nazizmin serb. Prandaj nuk ka nevojë për një gjykatë të tillë që synon të aplikojë "drejtësi" selektive.

Festa dhe gëzimi të shprehura në Serbi, pas publikimit të deklaratës politike, vërteton karakterin antishqiptarë të këtyre dhomave të kësaj gjykate, kurse ekzaltimi deri në ekstazë i disa shqipfolësve që tashmë po manifestohen si hiena, dëshmon se ata gjithmonë me hir apo pahir, me vetëdije apo pa të, kanë qenë të rreshtuar në anën e atyre që po gëzohen pas pretendimeve se duhet të ndiqen penalisht drejtuesit e luftës çlirimtare.

Nëse Erich Fromm të ishte ende gjallë, duke e parë ekzaltimin e tyre do të mund të ishte inspiruar nga këto rreshtime anakronike dhe do të kishte shkruar edhe një vepër të re Ikje nga Liria. Kurse

disa postime nëpër portale e rrjete sociale më së miri e vërtetojnë tezën e Umberto Ecos, se Interneti ua ka dhënë fjalën edhe budallenjve...

Përmasë përpjekjeve për të penalizuar dhe devalorizuar kontributin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe bashkëluftëtarëve të tyre, fshihen përpjekjet për të devalorizuar luftën e drejtë çlirimtare të UÇK-së dhe rezultatet e saj.

Prapa kësaj objektivë qëndron Serbia por jam i bindur se do të dështojë në realizimin e saj, sepse akuzat e pretenduara janë konstruksione të sajura në zyrat e UDB-së dhe pastaj të ripërtypura edhe nga disa shqipfolës të rreshtuar në anën e tyre. Ato akuza nuk janë veçse një kullë prej letre, që nëse eventualisht do të shndërrohen në aktakuzë do t'u kthehen si bumerang...



# VIDOVDANI DHE POLITIKA GJENOCIDALE SERBE



**Nga Jakup KRASNIQI**

Tubimi i së dielës në Gazimestan konfirmoi për të satën herë se mungesa e konflikteve të armatosura nuk nënkupton me automatizëm paqen e qëndrueshme në Ilirik. Askush nuk mund ta mohojë se gjatë gjithë këtyre viteve të lirisë e të pavarësisë Kosova ka qenë dhe është edhe sot e interesuar për paqe të drejtë e të qëndrueshme në këtë gadishull evropian. Por paqja e mirëfilltë nuk mund të ndërtohet pa ndëshkimin e atyre që kanë kryer gjenocid të vazhdueshëm ndaj fqinjëve dhe popullsisë

joserbe në këtë pjesë evropiane, veçanërisht në Kosovë, meqë jemi te Vidovdani! Pa ndëshkimin e atyre që e mbajnë të gjallë edhe sot këtë frymë politike asgjësuese paqja është një iluzion. Politikën në Kosovë, në BE dhe ajo e SHBA-së duhet të jenë të përgjegjshme se strukturat politike të regjimit aktual të Beogradit, Kisha Serbe dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë, janë jo vetëm larg njohjes së krimeve që shteti i tyre ua ka shkaktuar shqiptarëve, por edhe larg angazhimeve që përgjegjësit e krimeve të dalin para drejtësisë. Në vazhdimësi, sidomos në ditën e Vidovdanit, kjo frymë përcillet sikur një pllakë e stërvjetruar gramafoni. Ky rast, kjo frymë, pra u jepet për çdo Vidovdan, ashtu sikurse ndodhi edhe këtë vit. Për këtë arsye, ndërtimi i paqes së drejtë në këtë pjesë të Evropës ende

nuk shihet në horizontin politik edhe për faktin se krimi po kërkohet jo atje ku duhet. Pa dyshim se kjo është pasojë e mosndëshkimit të gjenocidit që shteti i Serbisë jo vetëm një herë ka kryer në Kosovë dhe jo vetëm në Kosovë! Ç'paradoks?! Logjika e vjetër mbisundon në institucionet e reja të shtetit serb, në Akademinë Serbe të Shkencave dhe Kishën Serbe.

Dhe kjo logjikë e vjetër serbe, kjo strategji që predikohet nga instancat e larta vendimmarrëse serbe, nuk mund të prodhojë paqe e mirëkuptim, pos kërcënimeve të reja për paqen evropiane. Kjo logjikë me bazë mitomane (lexo: shoviniste) serbe ishte e është pengesa kryesore për ndërtimin e paqes së qëndrueshme dhe rrezik për konflikte të reja edhe përtej hapësirave të ish-Federatës Jugosllave. Kujtojmë pikërisht ditën e

Vidovdanit në Sarajevën e 1914-s dhe ajo që u prodhua: Lufta e Parë Botërore. Së këndejmi, si toleranca e pafrenuar që u tolerua nga qeveritarët në Kosovë, si toleranca e pakuptueshme që vjen nga Perëndimi, si inferioriteti dhe heshtja ndaj kësaj logjike luftënxitëse, nuk i kontribuon as ndërtimit të një paqeje të drejtë e as të qëndrueshme. Askund më shumë në Evropë sesa në Ilirik (Ballkan) nuk ka nevojë për një paqe të drejtë e të qëndrueshme për zhvillim e mirëkuptim. Paqe e cila do të garantojë siguri, stabilitet, zhvillim e mirëqenie për të gjitha kombet e këtij rajoni, fatkeqësisht të mbetura jashtë BE-së.

Për t'u krijuar ky realitet i ri duhet një shkurorëzim i plotë i secilit komb nga politikën kërcënuese e luftënxitëse. Por, logjika e Vuçiqit dhe e gjithë aparatit shtetëror

serb, logjika e akademikëve dhe e drejtuesve të Kishës Serbe, po u tregojnë të gjithëve se nuk është logjikë e paqes, e zhvillimit dhe e mirëkuptimit. Fundja, daullet bien për atë që ka vesh!

Duhet thënë edhe kjo: jo vetëm zhvillimet e Vidovdanit, por edhe zhvillimet e tjera të këtij qershori po tregojnë se një paqe e qëndrueshme në Ilirik ende është larg. Kjo që u tha do të duhej të sillte një frymë të re politike në Kosovë, por për këtë frymë a kanë vesh njishat e politikës shqiptare?! Fatkeqësisht, kjo frymë është duke munguar në çdo komunitet të organizimit shoqëror në Kosovë dhe përtej saj. Shfletimi i të gjitha formave të informimit e të komunikimit ndër shqiptarë e konfirmim papjekurinë e komunikimit politik në hapësirën shqiptare. Le të shpresojmë për një kthjellje politike të shqiptarëve në udhëheqje.



## Ish-kryeministri francez dënohet me burgim për keqpërdorim të fondeve publike

PARIS, 29 QERSHOR - Një gjykatë franceze ka dënuar të hënën ish-kryeministrin francez Francois Fillon me pesë vjet burgim, tri prej të cilave të pezulluara, për përvetësim të fondeve publike, skandal që i pati pamundësuar garën për zgjedhjet presidenciale të vitit

2017. Kjo gjykatë ka shpallur fajtores edhe gruan e Fillonit, Penelope, për pjesëmarrjen e saj në mashtrim, nga cili ka përfituar rreth 1 milion euro për punën e saj minimale si asistente parlamentare e burrit të saj, transmeton agjencia e lajmeve "Reuters".

Ajo është dënuar me tri vjet burgim të pezulluar. Gjyqtarja Nathalie Garavironi ka thënë se Fillon, 66-vjeçar, ka shfrytëzuar fondet publike për ta paguar gruan e tij në mënyrë disproporcionale me punën e bërë. "Zonja Fillon është punësuar

në një pozitë pa angazhim", ka thënë Gararino. Çifti Fillon do të apelojë vendimin, ka thënë avokati Antonin Levy. Kjo i bie që ata nuk do të shkojnë në burg përpara se Gjykata e Apelit të marrë vendim.



## Edhe 12 të vdekur nga Covid-19 në Maqedoninë e Veriut



SHKUP, 29 QERSHOR - Maqedonia e Veriut të hënën ka regjistruar 12 persona të vdekur nga Covid-19. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, pesë të vdekur janë regjistruar në Shkup, dy në Tetovë, dy në Strugë dhe nga një në Gostivar, Veles dhe Shtip. Kjo është shifra e më lartë e viktimitave që nga paraqitja e

pandemisë, duke e çuar numrin e të vdekurve në 298 persona. Gjatë 24 orëve të fundit janë realizuar 868 testime për Covid-19 dhe prej tyre 132 raste kanë rezultuar pozitivë me këtë virus. Numri më i madh i të infektuarve është në Shkup, gjithsej 57, pastaj në Tetovë 18,

në Kumanovë 10, Shtip 13, ndërsa në 13 qytete të tjera numri i të infektuarve është më i vogël se dhjetë. Pavarësisht numrit të lartë të të infektuarve, ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, ka deklaruar se Maqedonia e Veriut për momentin ka kapacitete për t'u përballur me virusin.

## Johnson: Koronavirusi ka shkaktuar katastrofë

LONDËR, 29 QERSHOR - Kryeministri britanik, Boris Johnson, e ka përshkruar krizën e koronavirusit si "katastrofë" për Mbretërinë e Bashkuar, por ka thënë se tani nuk është koha për të hetuar atë që mund të jetë bërë keq. "Kjo është një katastrofë. Mos t'i zbusim fjalët tona. Ka qenë një makth absolut për vendin dhe vendi ka përjetuar një tronditje të thellë", ka thënë Johnson për "Times Radio" në Britani.

Ai ka theksuar se qeveria detyrohet t'u japë shpjegim të gjithë atyre që kanë vuajtur. "E kuptoj plotësisht këtë dhe do ta bëjmë. Megjithatë, mendoj se tani nuk është momenti që të përqendrojmë sasi të madhe të

kohës zyrtare në këtë", është shprehur Johnson. "Por, ne po mësojmë mësim gjatë gjithë kohës", ka shtuar ai.

Mbretëria e Bashkuar është e pesta në botë sa i përket numrit të të infektuarve me koronavirus: mbi 312 000. Ajo është e para në Evropë me numër të viktimitave: mbi 43 600. Gjatë krizës me koronavirus, afro nëntë milionë punëtorë, ose më shumë se një e katërta e fuqisë totale punëtoresh, kanë humbur përkohësisht vendet e punës në Britani. Kjo i ka kushtuar shtetit mbi 24 miliardë funta. Vetë Johnsoni ka qenë i infektuar me koronavirus dhe për shërimin e tij është dashur të qëndrojë në kujdes intensiv.



## Kina fut në izolim strikt rreth 400 000 njerëz



PEKIN, 29 QERSHOR - Kina ka rikthyer izolimin strikt në një zonë pranë Pekinit, pas një rritjeje të vogël të numrit të rasteve me Covid-19.

Izolimi në qarkun Anksin të provincës Hebei prek rreth 400 000 banorë.

Zyrtarët thanë se Anksini "do të mbyllet plotësisht" dhe se "do të kontrollohet".

Vetëm punëtorët thelbësorë

lejohen të dalin nga shtëpitë, ndërsa një anëtar i një familjeje lejohet të dalë një herë në ditë për të blerë ushqime.

Anksini ndodhet rreth 150 kilometra në jug të Pekinit.

Mediat kineze thonë se në dy javët e fundit atje ka pasur 18 raste të reja.

Për të shmangur valën e dytë, autoritetet shëndetësore thonë se edhe rritjet e vogla të rasteve

merren shumë seriozisht.

Anksini nuk është aq i populluar sa qendrat e mëdha urbane të Kinës dhe ekspertët lokalë të shëndetit thonë se janë optimistë se përhapja e Covid-19 mund të ndalohet. Kina, e cila është vend i origjinës së Covid-19, ka regjistruar mbi 84 000 të infektuar dhe mbi 4 600 viktima, edhe pse këto shifra besohet të jenë më të larta.

## Zgjedhjet presidenciale në Poloni shkojnë drejt balotazhit

VARSHAVË, 29 QERSHOR - Rezultatet e pjesshme të zgjedhjeve presidenciale në Poloni tregojnë se presidenti aktual Andrzej Duda ka dalë i pari, por nuk ka siguruar 50 për qind të

votave të nevojshme. Me mbi 82 për qind të votave të numëruara, Duda, i cili mbështetet nga Partia në pushtet për Ligj dhe Drejtësi, ka fituar 45.7 për qind të tyre. Në

vendin e dytë ka dalë Rafal Trzaskowski, kryetar aktual i Varshavës, me 28.5 për qind. Nëse rezultati konfirmohet, Duda dhe Trzaskowski do të përballen në balotazh më 12

korrik.

Pjesëmarrja në zgjedhjet e së dielës ka qenë e lartë, pavarësisht pandemisë së koronavirusit. Afro 63 për qind e votuesve kanë votuar.





# Standardi gjuhësor ndodhet në udhëkryq

Qëndrim MORINA

Gjuhët standarde jo doemos janë rrjedhim i një procesi të natyrshëm zhvillimi të një varianti gjuhësor, por fryt i ndërhyrjes së vullnetshme në kohë të caktuara e për qëllime të caktuara. Si një variant artificial, gjuha standarde ka nevojë për kujdesin e vazhdueshëm të bashkësisë gjuhësore që e flet. Prandaj, planifikimi gjuhësor është quajtur edhe zhvillim i gjuhës (language development). Duke marrë parasysh domenin në të cilat përdoret shqipja standarde (shkollë, administratë, media, institucione etj.), ajo me të drejtë ka devijim në të folur e në të shkruar. Po ashtu, shumë studiues (Lafe, Memushaj, Likaj etj.) kanë konsideruar se ky standard po devijon, po shkatërrohet e po dhunohet. Padyshim pajtohem që domenin përkatës ku flitet e shkruhet ky standard kanë aty-këtu devijim dhe do të duhej t'i kushtonin një rëndësi më të madhe, sidomos në të shkruar, por të themi se po dhunohet e po shkatërrohet, mendojmë se janë epitete të ngutshme, duke marrë parasysh fazën e standardizimit të shqipes, sfidat dhe kohën (komuniste) kur është mbajtur Kongresi i Drejtshkrimit (1972).

## A është shqipja e standardizuar?

Kur dëshirojmë të thurim lavde apo kritika për standardin gjuhësor të shqipes duhet t'i ngrehim disa pikëpyetje dhe të kuptojmë disa të dhëna, akull të ftohtë dhe pa ndjenja gardiane. Ç'është standardi gjuhësor? Kur ka filluar standardizimi i shqipes dhe cilët faktorë kanë ndikuar në zhvillimin apo moszhvillimin e tij? A është gjuha standarde vetëgjuha? Çfarë roli kanë dialektet në këtë zeje?

A i ka kaluar shqipja të gjitha fazat e zhvillimit për ta marrë epitetin "standardizim"?

Koncepti "gjuhë standarde" tingëllon disi si i turbullt. "Gjuhët standarde janë produkt i një ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë dhe të pamenduar nga ana e shoqërisë" (Hudson, 2002:43). Sipas linguistëve (Haugen 1996; Mathiot dhe Garvin 1959) gjuha standarde duhet t'i kalojë disa procedura që të marrë epitetin

"standardizim". Dhe, ato janë: Përzgjedhja, Kodifikimi, Kultivimi i funksionit dhe Pranimi.

Të ndalemi te këto çështje veç e veç.

Duke marrë parasysh se formimi i gjuhës standarde ka kaluar nëpër një rrugë historike të gjatë më se një shekull, idetë e para për formimin e saj qenë shfaqur në kohën e Rilindjes Kombëtare, do të thotë në mes të shek. XIX dhe ndikuan disa faktorë, si: politikë, ekomomikë, socialë, kulturorë etj (Munishi, 2013:15).


Përzgjedhja nënkupton që një formë a tjetër të zgjedhet një variant i caktuar për ta kultivuar gjuhën standarde në disa domene përkatëse. Në rastin e shqipes u zgjodh varianti toskë, në një epërsi të madhe, krahasuar me variantin gegë – pra, me shumë pak barasvlerë; Kodifikimi nënkupton që folësit duhet t'i shkruajnë format e sakta - të përzgjedhura nga varianti që është standardizuar - në këtë rast të variantit toskë. Në Kongresin e Drejtshkrimit (1972) u propozua dhe u pranua një tufë rregullash që herë-herë ishin edhe të p a a r g u m e n t u e s h m e shkencërisht, sepse shihej dhe shihet edhe sot, që mungoi argumentimi shkencor karshi elitave politike të asaj kohe (komuniste).

Kultivimi: një gjuhë standarde që përzgjidhet e kodifikohet, patjetër kërkon edhe kultivimin e saj.

Pranimi: gjuha standarde, kur pothuajse kalon me sukses të gjitha fazat e standardizimit, kërkon edhe fazën e rishikimit në mënyrë që të maten dhe testohen gabimet e mundshme të kohës, që përfundimisht të shkojë edhe deri te faza e fundit, e që është pranimi. Pra, një gjuhë pranohet që është standardizuar kur kalon nëpër këtë rrugë dhe kalon me sukses fazat e cekura më lart.

A i ka kaluar shqipja këto faza? Standardi gjuhësor i shqipes ka kaluar fazën e përzgjedhjes, kodifikimit, kultivimit (jo mjaftueshëm), por që i mungon ajo e rishikimit dhe e pranimit. Duke marrë parasysh kriteret dhe përmbushjen e tyre, mund të përfundojmë se gjuha shqipe nuk është e standardizuar, por që ka një tufë rregullash që herë-herë po i shërbejnë për të mirë e herë-herë po e ngufatin atë.

Një çështje tjetër që ngatërrohet



shumë shpesh në diskursin publik dhe nganjëherë edhe në atë shkencor (fushë të ngushtë - gjuhësisë) është mosqartësimi apo moskuptimi i drejtë i fjalës *standard*. Siç thamë edhe më lart, standardi është vetëm një varietet artificial dhe nuk përbën gjuhën në tërësi. Pra, *standardi nuk është gjuha*. Një pikë tjetër ku gjithmonë ekziston debati është që standardi dhe dialektet nuk janë një, por nuk janë edhe shumë të ndryshëm. Dallimi i vetëm që ekziston mes standardit dhe dialekteve është prestigji: një standard ka një prestigj që një dialekt nuk e ka (Hudson, 2002; 42).

## Ndikimi i internetit në shkrimin e shqipes standarde

Me futjen në përdorim të pajisjeve elektronike është shtuar pesha e asaj që shumë herë quhet edhe *gjuhë e internetit*, me të cilën duhet kuptuar ligjërimi elektronik, një lloj i ri i shfaqjes së gjuhës krahas ligjërimin të përditshëm. Ligjërimi elektronik ka marrë hov edhe me krijimin e rrjeteve sociale, duke u përdorur për komunikim midis individëve për një mesazh më të shpejtë. Madje, kohën e fundit, në këto rrjete sociale ("Facebook", "Instagram", "Snap" etj.) është bërë njëfarë kriteri për shkrimin e shqipes standarde, për të cilin, nëse eventualisht dështon në shkrimin e formave të sakta, të korrigjojnë dhe të përqeshin. Kjo është një ndihmesë sepse krijon një përdorim paralel me atë të librave e gazetave.

Mirëpo, për shkak të kohës dhe shpejtësisë së shkrimit, gabimet janë të natyrshme. Këto rrjete sociale kanë zëvendësuar shkronjën *ë* me *e* dhe *ç* me *q*. Pothuajse shumica e kuptojnë këtë marrëveshje dhe nuk e cilësojnë si mosdije.

Pa asnjë dyshim *gjuha e internetit* është pasqyrë e mirë e

shfaqjes së njohjes së standardit gjuhësor, por nuk është përgjegjëse për "prishjen" e tij. Pra, ajo vetëm zbulon disa të meta të zbatimit dhe tregon shkallën e përvetësimit nga folësit që e shkruajnë.

## Mbrojtja e standardit gjuhësor

Kur flasim dhe diskutojmë për varietetin standard të gjuhës shqipe duhet të jemi në gjendje t'i dallojmë dy aspekte: njëri aspekt është ai i përdorimit, një tjetër aspekt është ai i vështrimeve teorike rreth standardit.

Duke u nisur nga kjo kuptojmë se ky standard (aktual) duhet t'u shërbejë folësve dhe jo e kundërta. Duke marrë parasysh atë që thamë më lart (shih *A është shqipja e standardizuar?*), përfundua që gjuha standarde ka nevojë për kalimin e disa etapave vijuese për një përdorim më të mirë. Nisur nga kjo, gjuhëtarë Rami Memushaj (2015:373) thotë se gjuha standarde është një mal që s'e shemb dot duke i hapur ca tunele. Në këtë drejtim bie ndesh së pari ajo që përmendëm për fazat e standardizimit dhe, së dyti, që standardi gjuhësor duhet të jetë në shërbim të folësve dhe jo e kundërta.

Pra, kur themi *përmirësim* nuk nënkuptojmë *përmbyse*, sepse mendojmë se ky standard, me pak të meta që ka, lirisht mund të konsiderohet si një nga arritjet më të mëdha të shek. XX. Por, shoqëria jonë sa i përket standardit duhet të jetë më e hapur sepse gjer më tash kemi dy lloje qëndrimesh:

*qëndrim i betonuar*, i atyre që thonë se nuk duhet hequr asnjë tullë kësaj ndërtese, dhe *liri e tepruar* e atyre që për çdo pikë a presjeje duhet të mbahen kongrese e të ndërhyjnë në të.

Në gjithë këtë katrahurë, mendojmë se duhet gjetur një rrugë e mesme.

Këto dy lloje qëndrimesh mund të sjellin edhe teori konspirative për mbrojtjen me ligj të standardit gjuhësor, që mund të vijjnë nga ata që e duan gjuhën dhe që ia duan të mirën. Por, një çështje duhet sqaruar: *nga kush ta mbrojmë atë standard?*

Nëse mendohet të mbrohet nga ata që kanë një liri të tepruar mbi standardin, ndoshta edhe mund të pranohej;

Nëse mendohet të mbrohet nga ata që po bëjnë shkelje normative, ndoshta edhe mund të pranohej.

Por, nuk duhet harruar një gjë: ata janë folës të shqipes dhe nuk mund t'ua ndalojmë atyre të flasim e shkruajnë gjuhën (gjuhën 2.) e tyre. Kjo është shkelje normative e standardizimit.

Thamë këtë sepse kohën e fundit (vitet e fundit) ka qarkulluar një ide e disa gjuhëtarëve nga Shqipëria, si: Memushaj, Lafe, Shkurtaç, që t'i drejtohen me një letërpropozim kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, që të mbrohet shqipja standarde me ligj të veçantë. Kjo ngjalli shumë debat mes gjuhëtarëve nga Shqipëria dhe Kosova në të cilin, pashmangshëm, po futemi edhe ne.

Prof. Seit Mansaku këtë letër e quajti fyese. "Letra e profesorëve për Ramën, fyese" (gazeta "Dita", 2014).

Mendojmë se propozimi i profesorëve ishte i ngutshëm, jo dashakeq, por i pamenduar mirë, sepse asnjëherë nuk duhet harruar atë që standardi gjuhësor ndihmohet nga varietetet e tjera (dialektet) që të mbijetojë. Dhe, *si mund të mbrohet një varietet i caktuar me ligj të veçantë karshi të tjerëve?*

Propozimi i gjuhëtarëve të lartpërmendur ka tri defekte:

*i pasaktë*, nuk mund të flitet për shkatërrim të gjuhës;

*johistorik*, sepse shqipen nuk kanë mundur ta shkatërrojnë as perandoritë më të fuqishme, e të më folësit e saj, dhe

*i pamenduar mirë*, sepse nuk mund ta mbrojmë një varietet gjuhësor prej folësve të tij shqiptarë.

Krejt në fund duhet ta përsëritim edhe një herë se *përmirësimi* i standardit nuk nënkupton *përmbyse* e tij. Dhe, kjo bie ndesh me thënien e shkrimtarit Rexhep Qosja, që "*shqiptarët janë i vetmi komb, ajka e të cilit kritikon gjuhën standarde*".



**E rrallë**

## Minatori bëhet milioner brenda natës

Jeta e një personi mund të ndryshojë përgjithmonë atëherë kur nuk e pret fare atë. Një minator nga Tanzania, baba i më shumë se 30 fëmijëve, u shndërrua në milioner brenda natës pasi Saniniu Laizer shiti dy gurë të çmuar të cilët i kishte nxjerrë nga një minierë, shifra e të cilave shkoi në 2.4 milionë euro. Tanzanite është një gur i çmuar i cili përdoret vetëm për të prodhuar stoli të shtrenjta dhe mund të gjendet



vetëm në minierat e Tanzanisë. Është një ndër gurët më të rrallë të gjetur në tokë, madje ekspertë dhe arkeologë shprehen se brenda 20 vjetëve ato mund të zhduken.

**FOTO E DITES**



Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të hënën është mbajtur ceremonia ushtarake e diplomimit të 15 kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së të gjeneratës së studimeve 2016-2020. Pjesë e këtij diplomimi ishte edhe djali i heroit Shkëlzen Haradinaj, Luani.

**E jashtëzakonshme**

## Pas 100 vjetësh zbulohet një tjetër anije vikingësh

Në Norvegji kanë filluar gërmimet për nxjerrjen e një anijeje vikingësh, e para e zbuluar në vend që prej 100 vjetësh, një zbulim i rrallë që mund të ndihmojë në rritjen e njohurive për



këtë epokë. E zhytur nën tokë, anija e Gjellestad, emri i lokalitetit ku ajo ndodhet në juglindje të mbretërisë, ishte zbuluar në vitin 2018 në sajë të një radari të depërtueshëm në tokë.

**BARSOLETA E DITËS**



Njëri kishte mbetur pa martuar duke kërkuar vajzë të përsosur. Kur u bë 70 vjeç, dikush e pyeti: - "Ke udhëtuar në gjithë botën. Si nuk e gjeje një vajzë të përsosur diku?" Plaku u pikëllua shumë dhe tha: - "Një herë isha afër një vajze të tillë, por..." Tjetri vazhdoi: - "Po ç'ndodhi? Pse nuk u martove me të?" Plaku, edhe më tej i pikëlluar, ia ktheu: - "Ç'të bëj?! Ajo, po ashtu, kërkonte djalin e përsosur".



**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**

## Refuzoi t'i shërbente klientes pa maskë, kamerieri shpërblehet me 50 mijë dollarë

Një kamerier në San Diego ka fituar mbështetje të madhe në rrjetet sociale, pasi ai refuzoi t'i shërbente një gruaje e cila nuk mbante veshur maskë, e cila e zemëruar u përpoq ta turpëronte atë online, por s'ia doli.



Siç shkruajnë mediat amerikane, një grua në San Diego nuk u shërbye nga kamerieri në një lokal të Starbucks vetëm pse ajo nuk kishte vendosur maskën si mbrojtje ndaj Covid-19. Gruaja e irrituar bëri një foto dhe më pas shkroi në 'Facebook': "Takohuni me Lenin Gutierrez nga Starbucks, i cili nuk pranoi të më shërbente mua sepse nuk kisha vendosur maskën. Herën tjetër do të pres policët dhe do të sjell një ekip mjekësor". E nëse gruaja e quajtur Amber Lynn Gilles priste që atë ta mbështesnin dhe të sulmonin kamerierin, ndodhi e kundërta. Shumë njerëz i shpjeguan se kamerieri i Starbucks vetëm po ndiqte protokollin, e madje nisën dhe një fushatë "Go fund me" për të.

Fushata për mbledhjen e parave nisi nga Matt Cowan, i cili nuk njihete as gruan dhe as kamerierin. E deri tani janë mbledhur mbi 50,000 dollarë për Gutierrez.

Djali i ri shpjegoi incidentin, duke thënë se kishte dashur t'i tregonte gruas rregullat për vendosjen e maskave, por ajo nuk kishte pranuar.

Në një video në Facebook, Gutierrez tha se ai ishte duke punuar në Starbucks por ëndrra e tij ishte të punojë si një balerin dhe instruktor kërcimi. Para karantinës, ai u mësonte fëmijëve si të kërcenin dhe tha se paratë që i kanë dhuruar, do i përdorë për t'iu rikthyer mësimin të fëmijëve përsëri.

"Gjithçka që dua të bëj vërtet është të jem në gjendje t'u mësoj të tjerëve të kërcenjë dhe t'u tregoj se sa e dua dhe sa ka ndikuar kërcimi tek unë. Nëse mund t'ia tregoj dikujt dhe të ndryshoj jetën e tyre, siç kërcimi ndryshoi jetën time." - është shprehur Gutierrez i cili i ka falënderuar të gjithë për mbështetjen.



**DASHI**

Sot nuk do të jetë një ditë ideale për ta shprehur dashurinë apo për të vendosur datën e dasmës suaj.



**DEMI**

Ju jeni të rrethuar nga miqtë me sens të përbashkët, të cilët do të jenë në gjendje t'ju këshillojnë më së miri.



**BINJAKËT**

Parashikimet më të mira për ditën e sotme kanë të bëjnë me dashurinë, jetën në çift, fëmijët dhe kohën e lirë.



**GAFORRJA**

Puna dhe biznesi nuk po funksionojnë siç duhet. Pandemia ka krijuar fatkeqësi kudo, jo vetëm tek aktivitetet tuaja.



**LUANI**

Energjitë e mëdha dhe komunikimi do të jenë pikërisht ato që duhen për ta rritur aktivitetin tuaj profesional.



**VIRGJËRESHA**

Në zyrë do të merreni me një çështje parimi, pa pasoja të rënda. Lini kartat e kreditit në shtëpinë tuaj për të shmangur një shpenzim të madh.



**PESHORJA**

Sot do të jeni serioze dhe e zhytur në mendime. Disa prej jush do të reflektojnë mbi të kaluarën.



**AKREPI**

Ditën e sotme do të ndiheni shumë i hutuar. Deri nëse mos bëni asnjë lëvizje dhe mos merrni asnjë vendim.



**SHIGJETARI**

Fryma e iniciativës ju shtyn të lëvizni dhe të veproni pa humbur kohë. Sidoqoftë, duhet ta ndiqni saktësinë maksimale.



**BRICJAPI**

A punoni në një grup me të tjerët? Kujdes nga mashtrimi burokratik ose çështje që mund ta ngadalësojnë veprimtarinë e të gjithë grupit.



**UJORI**

E filloni javën më së miri. Në punë mund të mbështeteni në një planifikim pozitiv, i cili do të pasohet nga një realizim praktik dhe i kënaqshëm.



**PESHQIT**

Do të jetë një ditë e mërziqshme. Do të shkoni rreth të njëjtave gjëra, do të insistoni në një projekt që absolutisht duhet të përsoset.



## Ronaldo tregon muskujt në Itali, Georgina shfaqet seksi në jahtin luksoz



Javën e kaluar ata zbuluan se kishin nisur pushimet luksoze pasi u shfaqën teksa pushonin në një jaht. Cristiano Ronaldo dhe Georgina Rodriguez duket se kanë vendosur ta shijojnë ashtu siç duhet verën. 35-vjeçari dhe partnerja e tij

bukuroshe janë fotografuar duke kaluar kohën në Portofino, Itali. Futbollisti portugez tregoi muskujt teksa qëndronte i ulur në jaht, ndërsa 26-vjeçarja tërhoqi vëmendjen me një fustan të ngushtë që i ekspozonte bukur linjat trupore.

## 'Rolling Stones' kërkon që mos të përdoret muzika e tyre në fushatën e Trumpit



Presidenti amerikan Donald Trump akuzohet se ka përdorur në tubimet e veta këngë të grupit, pavarësisht mendimit kundër të Mick Jagger dhe pjesëtarëve të tjerë. Grupi rok 'Rolling Stones' ka paralajmëruar se ekipi i tyre ligjor po punon me organizatën për të drejtat muzikore BMI për ta ndërprerë përdorimin e materialeve në fushatën për rizgjed-

hjen e Trumpit. "Përdorimi i paautorizuar i këngëve të tyre do të përbëjë një shkëlqje të drejtës së autorit. Kështu grupi kërcënon me aksione ligjore dhe revoltat me presidentin. Nëse Donald Trump nuk do ta dëgjojë këtë paralajmërim do të përballet me një padi ligjore për shkëlqje të embargos dhe riprodhim të paautorizuar të muzikës", theksohet në reagimin e 'Rolling Stones'.



## Bukuroshja shkodrane "pushton" kopertinat italiane

Ajo është një nga modelet më të bukura shqiptare dhe më të komentuar në rrjete sociale. Bëhet fjalë për Angela Martinin, e cila prej vitesh jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo gjithmonë ka spikatur për bukurinë dhe elegancën. Prej disa ditësh bukuroshja shkodrane po shijon pushimet, e nuk ka ngurrar që të ndajë me ndjekësit disa nga

çastet më pikante. Vetëm pak ditë më parë Angela publikoi një video nga një jaht, ku tërhoqi vëmendjen me lëvizjet provokuese. Ndërsa së fundmi, modeluesja është shfaqur në kopertinën e revistës italiane "Cleon". "E bukur si dielli", thuhet në kopertinë, ku Angela bie në sy e veshur me një fustan të bardhë, ku duket mjaft joshëse dhe në superformë.

## Beyonce jep mesazh për zgjedhjet në ShBA



Tani është Beyonce ajo që flet për zgjedhjet e ardhshme presidenciale në ShBA. Nuk e bën drejtpërsëdrejti, por me një ftesë për votim që është një thirrje e vërtetë nën armë kundër Donald Trumpit. "Duhet të votojmë sikur jetët tona të vareshin nga kjo sepse është pikërisht kështu", ka thënë ajo nga skena

virtuale e Bet Awards, "votimi në zgjedhjet e ardhshme është mënyra për t'i dhënë fund një sistemi racist dhe të pabarabartë. Zërat tuaj duhet të dëgjohen. Po u dëshmoni paraardhësve tuaj se lufta e tyre nuk ka qenë e kotë", ka thënë Beyonce duke iu drejtuar publikut afro amerikan dhe aktivistëve anti racistë.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Fitojnë Prishtina dhe Ballkani, gabon Gjilani

Prishtina nuk ka gabuar në përballje me kampionin në fuqi, Feronikelin. Fitore të hënën regjistroi edhe Ballkani ndaj Vushtrrisë, kurse Gjilani nuk ka mundur të marrë më shumë se një barazim në përballje me Llapin



ndeshjeje Ballkani ka grumbulluar 53 pikë dhe mbetet në garë për titull, kurse Vushtrria është e njëmbëdhjeta me vetëm 16 pikë të grumbulluara.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 29 QERSHOR** - FC Prishtina u është rikthyer fitoreve në derbin ndaj Feronikelit (3-1) që është zhvilluar të hënën në mbrëmje në stadiumin "Fadil Vokrri". Pas barazimit në xhiron e kaluar ndaj Llapit, Prishtina ishte më efikase ndaj kampionëve në fuqi të elitës dhe me plot meritë ka marrë maksimumin e pikëve. Të parët në epërsi kanë kaluar vendësit në minutën e 11-të, kur asistimin e Armend Thaqit në gol e ka shndërruar Otto John. Dy minuta më vonë për rezultatin 1-1 është përkujdesur

Albert Dabiqaj. Golin e dytë për kryeqytetasit e ka shënuar Gauithier Mankenda në fund të pjesës së parë. Në pjesën e dytë në listën e golashënuesve është regjistruar edhe Ahmed Januzi, i cili ka vulosur rezultatin final 3-1. Pas tri pikëve të reja, Prishtina është rikthyer në pozitën e dytë me 54 pikë, kurse "Nikli" ka mbetur në vendin e pestë me 44 pikë. Skuadra tjetër që është në garë për titull të kampionit në IPKO Superligë, Gjilani, nuk ka arritur të marrë më shumë se një pikë në përballje me Llapin, pasi ndeshja ka përfunduar 2-2. Skuadra e drejtuar nga trajneri Tahir Batatina dy herë ka kaluar në epërsi me anë të sulmuesit të

krahut, Valmir Veliu (15', 42'), por Keita Razak (22') dhe Gerhard Progni (90') kanë siguruar një pikë për skuadrën e Gjilanit. Pas këtij barazimi, Gjilani ka rënë në pozitën e katërt dhe tash është gjashtë pikë pas skuadrës lidere, kurse Llapi zë vendin e gjashtë me 39 pikë. Në ndeshjen tjetër që është

zhvilluar të hënën në Suharekë, Ballkani e ka fundosur skuadrën e Vushtrrisë (3-1), e cila në sezonin e ardhshëm do të bëjë gara në Ligën e Parë. Mirlind Daku, Blend Baftiu nga penalltia dhe Arbër Prekazi kanë shënuar për vendësit, kurse golin e nderit për mysafirët e ka shënuar Kushtrim Fazliu. Pas kësaj

IPKO SUPERLIGA		
Prishtina - Feronikeli		3-1
Gjilani - Llapi		2-2
Ballkani - Vushtrria		3-1
Drita - Dukagjini		2-0
Drenica - Trepça '89		2-4
Flamurtari - Ferizaj		3-2
Tabela		
		PIKË
1. Drita	27	58
2. Prishtina	27	54
3. Ballkani	27	53
4. Gjilani	27	52
5. Feronikeli	27	44
6. Llapi	27	39
7. Flamurtari	27	36
8. Drenica	27	35
9. Trepça '89	27	31
10. Ferizaj	27	26
11. Vushtrria	27	16
12. Dukagjini	27	10

# Saraçini: Bashkërisht e përmbyllëm suksesshëm edicionin

**PRISHTINË, 29 QERSHOR** - Kryetari i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, u është drejtuar sportdashësve në Kosovë me rastin e përfundimit të edicionit 2019/2020 në hendboll. Saraçini ka thënë se sezoni është përmbyllur në mënyrë të sukseshme ani pse pandemia ka sjellë mjaft probleme. "Besa Famgas, Prishtina, Vushtrria, Istogu, por edhe të gjitha klubet, meritojnë respekt e falënderime për punën dhe angazhimin gjatë edicionit të vështirë. Të tillë e bëri pandemia, që po ka ndikim global edhe në sportin tonë. Por me angazhim të përbashkët



kemi bërë një përmbyllje të sukseshme të edicionit. Vërtet sfidat na forcojnë dhe na dërgojnë në nivel më të lartë. Kështu do të jetë edhe këtë herë. Dorëzimi, tërheqja, nuk kanë

qenë dhe nuk do të jenë opsion për ne", ka thënë Saraçini, i cili ka vlerësuar se Besa Famgas ka fituar me meritë titullin dhe Kupën në konkurrencën e meshkujve, kurse me meritë,

sipas tij, triumfuan edhe Ferizaj në kampionat dhe Vushtrria në Kupën. "U bëmë model me vazhdim të garave, me krijimin e Task-Forcës për përballje me Covid-19, për kontrollim shëndetësor të pjesëmarrësve dhe për përfundim shembullor të edicionit. Besa Famgas fitoi titullin dhe Kupën të hendbollistët, Ferizaj fitoi titullin të hendbollistët, kurse Kupën e fitoi Vushtrria. U ndanë trofe edhe për grupmoshat. Më e rëndësishmja, kampanja përfundoi pa probleme dhe më të mirët u shpallën në bazë të meritave sportive. E lehtë nuk ishte. Si gjithnjë jemi sfiduar. Për

shembull një grup shikuesish të pandërgjegjshëm na krijuan telashe në ditën e finaleve. Falë Policisë së Kosovës dhe maturisë sonë u kontrollua gjendja", ka deklaruar Saraçini. Në fund, kryetari i FHK-së falënderoi policinë për kontributin, po ashtu edhe drejtuesit e institucioneve për madhështimin e finaleve me praninë e tyre. "Falënderimi më i madh shkon për klubet e lojtarët që edhe një herë dëshmuar përkushtimin për avancim të përbashkët. Angazhime të tjera na presin, me forca të përbashkëta drejt sukseseve të reja", ka shtuar Saraçini.

## Paqarada, pas gjashtë vjetësh qëndrim, largohet nga Sandhauseni

**SANDHAUSEN, 29 QERSHOR** - Repreruesi i Kosovës në futboll, Leart Paqarada, ka njoftuar se do të largohet nga skuadra e Sandhauseni. 25-vjeçari ka luajtur gjashtë vjet

për këtë skuadër, kurse tash është në kërkim të një skuadre të re. Mbrojtësi i majtë ishte zhvilluar te Werder Bremen dhe te Bayer Leverkuseni. Këtë edicion është

paraqitur në 32 ndeshje kampionale, ndërsa ka kontribuar me një gol e pesë asistime. Ka kompletuar të gjitha 32 ndeshjet, kurse ka munguar në një ndeshje për shkak të kartonëve

e në një tjetër me leje të klubit. "Gjashtë vjet dhe 160 ndeshje. Ka qenë kohë shumë e bukur. Faleminderit dhe lamtumirë! Ju uroj shumë suksese në të ardhmen", ka thënë Paqarada.





## Tahiri: KHF Vushtrria do të shpërbehet për suksesin e arritur

VUSHTRRI, 29 QERSHOR - Fituesja e Kupës së Kosovës në hendboll, KHF Vushtrria, është pritur të hënën nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri. Tahiri ka thënë se, përveç subvencioneve,

klubi triumfues i Kupës do të shpërblehet edhe me një çmim të veçantë. "Në emrin tim dhe të qytetit të Vushtrrisë falënderova kryetarin e klubit, Fadil Maxhuni, trajnerin Arben Parduzi, kapitenen

Shqipe Tahiri dhe të gjitha hendbollistet që po na bëjnë krenarë me sukseset e tyre. Komuna e ka përkrahur klubin me 7 000 euro nga subvencionet, ndërsa do të ndajë edhe shpërblim të veçantë

edhe për titullin e fituar. Po ashtu, i sigurova drejtuesit e klubit dhe hendbollistet që komuna do t'i përkrahë edhe në garat ndërkombëtare. Sukseset kampione", ka thënë Tahiri.



## Konjusha: E mirëpresim formimin e Përfaqësueses A për femrave

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) është duke shikuar mundësinë që të paraqesë për herë të parë në garat ndërkombëtare Përfaqësuesen A në konkurrencën e femrave. Kjo do të ishte hera e parë që Kosova A (Femrat) do të luante zyrtarisht në garat evropiane. Sidoqoftë, ky propozim duhet të miratohet në Bordin e FBK-së, ku do të diskutohet më pas se, edhe me cilat përfaqësuese të reja të femrave do të garojmë në FIBA Kampionate Evropiane në vitin e ardhshëm. Njëra nga basketbollistet më të dalluara në Kosovë, Irma Konjusha, e ka mirëpritur këtë ide. "Formimi i Përfaqësueses A te femrat është një lajm shumë i mirë për ne që luajmë basketboll. Do të ishte një shpërblim për mundin që kemi bërë me vite. Formimi i Kosovës A do të ishte shumë i rëndësishëm për basketbollin e femrave dhe një motivim për vajzat e reja që të merren edhe



më shumë me basketboll", ka thënë Konjusha për faqen zyrtare të FBK-së. Basketbollistja e Mabetex Prishtinës ka folur edhe për rëndësinë që do të kishte formimi i Kosovës A te femrat. "Do të shpërblehej sakrificat me vite, por do të ishte edhe një mundësi të garonim me shtete që kanë cilësi të ngjashme me ne. Gjithashtu, shumë lojtare

do të fitonin përvojë ndërkombëtare. Mund të formojmë një ekip të konsoliduar me lojtare me përvojë, por edhe me ato të reja. Do të ishte shumë i mirëseardhur formimi i Kosovës A te femrat. Do të ishte një përvojë e paharrueshme, por edhe historike për basketbollin e femrave në Kosovë", ka shtuar Konjusha.

## NBA rinis më 30 korrik me derbin e Los Anxhelosit



ORLANDO, 29 QERSHOR - NBA ka publikuar kalendarin e ndeshjeve që do të luhen nga 30 korriku, kur dhe do të rinisin ndeshjet e sezonit 2019-2020, sezon i ndërprerë që në mars për shkak të koronavirusit. Ndeshjet do të luhen në Orlando, Florida, ku do të grumbullohen 22 skuadrat që do ta vijojnë garën për titull. Sfidat e parë që do të luhen më 30 korrik është ajo mes Utah Jazzit dhe New Orleansit. Menjëherë pas

këtij takimi do të luhet derbi i Los Anxhelosit mes Lakersit dhe Clippersit, dy ekipet më të mira në Konferencën e Perëndimit. Çdo ditë do të luhen nga 6 ndeshje. Më 31 korrik do të luhen 6 ndeshje të tjera, ku spikatin Boston-Milwaukee, dy ekipet më të mira në Konferencën e Lindjes si dhe sfida mes Houstonit e Dallasit. Ndeshjet do të luhen në 3 fusha të ndryshme dhe maksimumi mund të luhen 7 ndeshje në ditë.

## Gomez: Kam ëndërruar gjithmonë ta mbyll karrierën në Shtuttgart

Mario Gomez i ka dhënë fund lojës së futbollit. Sulmuesi gjerman sezonin e fundit luajti me Stuttgartin në Bundesliga 2 dhe ndihmoi skuadrën e zemrës të rikthehet në elitë. Diçka të tillë ia kishte premtuar vetes dhe e mbajti fjalën. Shtatë gola shënoi këtë sezon lojtari që mbush 35 vjeç më 10 korrik. Gomez i ka luajtur me ekipe si Stuttgart, Bayern Munchen, Fiorentina,

Beshiktash dhe Wolfsburg, teksa numëron 31 gola të shënuar me kombëtaren gjermane. "Isha i sigurt që në fillim të sezonit që do të riktheheshim në Bundesligë. Kisha vendosur që ky do të ishte sezoni im i fundit te Stuttgart, në Gjermani dhe, ndoshta, si futbollist. Kam ëndërruar gjithmonë ta mbyll karrierën këtu", ka thënë Gomez.



### SHKURT

#### Dy klube italiane në garë për Ismajlin

Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Edy Reja, ka dhënë një intervistë për mediat italiane rreth kombëtares shqiptare. Më saktësisht, Reja ka folur për repartin e mbrojtjes duke lavdëruar emrat si Marash Kumbulla, Berat Gjimeshi e Ardian Ismajli. Për mbrojtësin prishtinas, Reja ka zbuluar se ka dy oferta nga skuadrat italiane, që më parë nuk ishte bërë e ditur. "Mbrojtës shumë i rëndësishëm për ne është edhe Ismajli që luan te Hajduku i Splitit. Ai ka dy oferta të rëndësishme nga Lecce dhe Benevento", ka deklaruar trajneri i kombëtares kuqezi.

Ismajli ka shkëlqyer në dy edicionet e fundit me Hajdukun dhe kjo ka bërë që edhe çmimi i tij të rritet në mbi tre milionë euro.

#### Bardhi bie në sytë e Artetës

Pas tre sezonesh në kampionatin spanjoll me Levanten, mesfushori me origjinë shqiptare, por i lindur në Shkup, Enis Bardhi, është gati për një tjetër hap të rëndësishëm në karrierën futbollistike. Paraqitet e mira të 25-vjeçarit kanë rënë në sy të trajnerit të Arsenalit, Mikel Arteta, i cili u ka kërkuar drejtuesve të klubit që ta transferojnë futbollistin e Maqedonisë së Veriut në Londër. Debutimin si profesionist Enis Bardhi e bëri te Prespa Birluk, ku luajti 10 ndeshje dhe shënoi 5 gola, ndërsa më pas u transferua te hungarezët e Ujpestit, ku luajti për tre sezone dhe në 79 ndeshje, shënoi 19 gola. Prej verës së 2017-s është pjesë e spanjollëve të Levantes, ku ka luajtur 75 ndeshje në tre sezone dhe ka shënuar 15 gola. Ekzekutimi i goditjeve standarde është një nga specialitetet e Bardhit, i cili ka mahnitur shpesh me gola.

#### Sneijder: Periudha tek Interi ka qenë më e mira në karrierën time

Pas vari këpucët në gozhdë, Wesley Sneijder ka publikuar një autobiografi në një libër, teksa një pjesë të rëndësishme në të zë edhe skuadra e Interit. Holandezi fitoi tripletën në drejtimin e Jose Mourinhos, një aventurë që duket se i ka lënë shumë mbresa. "Periudha e Interit ka qenë, thjesht, më e mira në karrierën time, me shumë suksese. Me Mourinhon kemi pasur menjëherë një lidhje të ngushtë. Kam pasur disa trajnerë të zotë, mes tyre edhe Van Gaalin që e vendos mes tre të parëve, por Mourinho ka qenë numri një. Si trajner shprejsoj të bëhem një miks mes të dyve", ka shkruar Sneijderi.

#### Mercedesi garon me makinë të zezë

Makina gjermane Mercedes ka vendosur ta vijojë betejën e saj në luftën kundër racizmit. Në garën e parë sezonale të Formula 1, që zhvillohet më 5 korrik në Austri, Mercedesi do të ketë një pamje krejt të veçantë. Në këtë garë makina gjermane nuk do të jetë në ngjyrat e saj të zakonshme, por do të jetë tërësisht e zezë. Një ngjyrë e përzgjedhur për ta vijuar betejën ndaj racizmit, betejë që kohët e fundit është bërë shumë e ndjeshme në këtë sport. "Jemi krenarë për kulturën tonë dhe vlerat që përçon ajo. Vetëm 3 % e punonjësve tanë iu përkasin pakicave dhe vetëm 12 % janë femra. Ndaj dhe do të vazhdojmë t'i mbështesin këto pakica, duke ndërmarrë këtë nismë", thuhet në komunikatën e Mercedesit. Makina Mercedes që pilotët Lewis Hamilton dhe Valtteri Bottas do ta kenë në këtë garë do të ketë edhe disa shkrime. "Jepi fund racizmit" dhe "Ne garojmë të bashkuar".





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit  
Opština Gnjilane  
Municipal Gjiçan  
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-149 dhe nenit 15 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Gjiçanit shpall:

## KONKURS

### 1.ZYRA E KRYETARIT

#### Sektori ligjor

##### 1.1 Titulli i pozitës : Udhëheqës i sektorit ligjor

Koeficienti: 8.5

Procedura e aplikimit: **I jashtëm**

Lloji i emërimit: **I karrierës**

Nr. i ekzekutuesve: **1 (një)**

Titulli i mbikëqyrësit: **Kryetari i Komunës**

Orari i plotë : **40 orë në javë**

Nr. i referencës: **RN00006014**

**Qëllimi i vendit të punës:** Sigurimi i shërbimeve juridike dhe këshilluese ligjore për të siguruar menaxhim efektiv të rreziqeve ligjore dhe kontraktuale si dhe hartimi dhe shqyrtimi i legjislacionit sekondar.

#### Detyrat kryesore:

1. Udhëheq punën e gjithëmbarshme të sektorit dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave;
2. Menaxhon me stafin e sektorit dhe bënë ndarjen e detyrave tek varësit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore;
3. Shqyrton propozimet e rregulloreve dhe akteve të tjera që i propozohen Kuvendit të Komunës për miratim;
4. Harton rregulloret, urdhëresat administrative si dhe aktet tjera juridike që i lëshon kryetari i Komunës;
5. Siguron ndihmë juridike, shërbime dhe këshilla ligjore për drejtoritë, zyrat dhe sektorët e Komunës;
6. Siguron që projekt-rregulloret e propozuara dhe të hartuara të jenë në përputhje me standardet e ligjet përkatëse dhe politikat komunale, si dhe Statutin e Komunës;
7. Siguron përfaqësim dhe mbrojtjen e interesit të Komunës dhe institucioneve që financohen nga Komuna;
8. Bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrjen e tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e tyre në nivel me standardet e kërkuara;

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë universiteti, fakulteti juridik
- 4 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit
- Njohuri e mirë e ligjeve, rregulloreve në fushën përkatëse,
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim,
- Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë.
- Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, ose grupit punues,
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power point etj)

### Zyra e prokurimit

##### 1.2 Titulli i pozitës: Inspektor i ndërtimit

Koeficienti: 7

Procedura e aplikimit: **I jashtëm**

